



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 325 Akti

Nr. 442 Vendimi
Tiranë, më 14.9.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 10.9.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Juljan Çafka**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 12.11.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Menjëherë me hedhjen e shortit komisionerja Firdes Shuli dha dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit për këtë subjekt, për të cilin trupi gjykues, i shortuar me vendimin nr. ***, datë 20.11.2019, të Komisionit, vendosi¹ pranimin e kërkesës së saj. Me vendimin nr. ***, datë 4.12.2019, u caktua me short anëtar i trupi gjykues komisionere Alma Faskaj, si zëvendësuese e komisioneres Firdes Shuli. Më tej, me vendimin nr. ***, datë 10.4.2020, të Komisionit, me rishpërndarjen e çështjeve të komisioneres Alma Faskaj, u caktua me short relatore e çështjes, komisionerja Brunilda Bekteshi. Subjekti i rivlerësimit, përmes komunikimit elektronik, përkatësisht në datat 12.12.2019 dhe 5.8.2020, deklaroi se nuk ka konflikt interesi me trupin gjykues të shortuar/zëvendësuar që do të kryente procesin e rivlerësimit për të si subjekt.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 2.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Juljan Çafka, si dhe caktoi kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

¹ Vendimi nr. ***, datë 25.11.2019, i trupit gjykues.

5. Komisioni, në datën 28.7.2021, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, për të tria kriteret e rivlerësimit: për pasurinë, figurën dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; si dhe (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 23.8.2021 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; si dhe (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda 10 ditëve. Brenda afatit të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ në mënyrë elektronike.

7. Trupi gjykues, në datën 8.9.2021, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, në seancën dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar në të njëjtën datë, me anë të postës elektronike, se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 10.9.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

8. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

9. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Çafka. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 10.9.2021, për të rifilluar në datën 14.9.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Z. Juljan Çafka ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur, kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe krerët IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të

bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese² dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

12. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 26.6.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Çafka, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2008, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2008 - 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë e në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat

² Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (d) argumentimet e dhëna verbalisht në seancën dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2), të datës 26.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi ka rezultuar, si vijon:

1. Kursime nga paga (llogari rrjedhëse në Bankën Kombëtare Tregtare), në vlerën 1.166.500 lekë

1.1 Nga korrespondenca e mbajtur me BKT-në, kjo e fundit, me shkresën nr. ***prot., datë 20.1.2020, ka informuar se konfirmohet llogaria rrjedhëse në emër të z. Juljan Çafka, me gjendje në datën 26.1.2017 (kur subjekti ka depozituar deklaratën *Vetting*) në shumën 1.153.553 lekë. Kjo llogari është hapur në dhjetor të vitit 2014, në të cilën subjektit i kreditohet paga. Vihet re se vlera e gjendjes së dekluar nga subjekti nuk përputhet me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja, pasi gjendja korrespondonte me atë të datës 16.1.2017, dhe jo me gjendjen e datës 26.1.2017, kur është depozituar deklarata *Vetting*.

1.2 Trupi gjykues, pas verifikimit të deklaratimit të subjektit në raport me të dhënat bankare të administruara, ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit dhe, për rrjedhojë, konkludon se subjekti e ka dekluar saktë këtë llogari bankare.

2. Kursime nga paga në *cash*, në vlerën 250.000 lekë

2.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron për herë të parë kursime në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 dhe në vazhdim, pasqyruar si në tabelën e mëposhtme:

Viti	Përshkrimi	Vlera
2009	Kursime nga paga e detyrës si prokuror	71,668
2010	Kursime për vitin 2010. Burimi (paga)	120,000
2011	130.000 lekë llogari bankare (kursime nga paga)	130,000
2012	Kursime nga paga	300,000
2013	Kursime nga paga	250,000
2014	Kursime nga paga	580,000
2015	Kursime nga paga për vitin 2015	355,000
2016	Kursime nga paga	150,000
	Bashkëshortja deklaron: kursime page <i>cash</i>	500,000
	Bashkëshortja deklaron: kursime nga paga gjatë lejes së lindjes	274,000

2.2 Komisioni e ka pyetur³ subjektin për të saktësuar deklaratimet e tij në *cash*. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit pretendon vlera të tjera nga ato të pasqyruara në deklaratat periodike dhe sqaron se nuk ka deklaruar pakësime por vetëm kursime. Gjithashtu, ka shpjeguar se ka pasur gabime në deklaratimet e tij lidhur me likuiditetet në bankë dhe *cash*, pasi vlerat nuk përputhen me atë çka ka zotëruar realisht në çdo fund vit.

2.3 Komisioni, pasi ka analizuar deklaratimet periodike të subjektit, si dhe procesverbalin⁴ e mbajtur në dhjetor të vitit 2015 në ILDKPKI, ka vlerësuar t'i qëndrojë strikt deklaratimit periodik vjetor të bërë nga subjekti. Komisioni ka konsideruar gjendje *cash* në fund të vitit vlerat e deklaruara nga subjekti në çdo deklaratë periodike, përveç vitit 2011, ku vlera 130.000 lekë ka përfshirë gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe në bankë.

2.4 Nga analiza financiare, Komisioni konstatoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë shumat e deklaruara si kursime në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 dhe në vazhdim, pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën e analizës financiare për vitet 2008 - 2016, në fund të këtij vendimi.

2.5 Komisioni kreu analizën financiare edhe në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, 26.1.2017, për gjendjen e kursimeve *cash* në shumën 250.000 lekë.

2.6 Pas përllogaritjeve financiare të kryera nga Komisioni, u konstatua se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në vlerën 122.673 lekë për të krijuar shumën e kursimeve të deklaruara, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, i kërkoi të japë shpjegime⁵.

2.6.i Në shpjegimet e tij, subjekti ka parashtruar se deklarata *Vetting* i referohet gjendjes së tij pasurore dhe të bashkëshortes deri në kohën e deklaratimit, duke marrë parasysh jo ndryshimet në pasuri, siç përcakton ligji nr. 9049, datë 10.4.2003. Shuma e kursyer *cash* prej 250.000 lekësh, sipas tij, nuk përfaqëson kursimet e një muaji apo të një viti, por gjendjen e likuiditetit *cash* që kishte pasur deri në kohën e deklaratimit, të cilat kanë si burim krijimi kursimet nga paga.

2.6.ii Subjekti ka kontestuar përllogaritjet e Komisionit, pasi sipas tij llogaritja e bërë në analizën financiare të deklaratës *Vetting* duhet të merrte parasysh të ardhurat e tij në total gjatë gjithë viteve si prokuror dhe jo shumën 84.430 lekë (tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë lekë). Sipas subjektit, prej tij nuk janë shënuar pakësimet e shumave *cash* në këto vite dhe prandaj edhe në deklaratimin e pasurisë për vitin 2016 nuk ka shënuar kursime *cash*, pasi shuma prej 355.000 lekësh, e kursyer gjatë vitit 2015, dhe shuma prej 100.000 lekësh, e mbartur nga vitet e tjera, ishte pakësuar.

2.6.iii Sipas subjektit, prej kursimeve *cash* të grumbulluara në vite, në vitin 2016 ka depozituar në bankë shumën prej 600.000 lekësh të kursyera dhe së bashku me balancën që ndodhej në atë kohë në llogari është krijuar shuma 1.120.723 lekë⁶. Shuma prej 250.000 lekësh, e deklaruar e kursyer

³ Pyetësor nr. 2, datë 15.6.2021.

⁴ Depozituar me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020, të ILDKPKI-së.

⁵ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁶ Shihni shpjegimet e dhëna në vitin 2015 në ILDKPKI.

në deklaratën *Vetting*, përbën pakësim të shumës 355.000 lekë *cash* të kursyer gjatë vitit 2015 dhe të shumës 100.000 lekë, të cilat ishin kursime *cash* të krijuara në vite.

2.6.iv Sikurse gjatë hetimit, edhe në qëndrimin e tij pas rezultateve të hetimit, ka parashtruar se në deklaratimet e tij nuk ka specifikuar kursimet *cash* dhe në bankë, por i ka vendosur në total.

2.6.v Lidhur me mundësitë financiare për vitin 2016, subjekti ka parashtruar se Komisioni duhet të ketë parasysh përbërjen e tij familjare, të ardhurat e familjes dhe shpenzimet e kryera, duke i kërkuar Komisionit që shpenzimet e jetesës të përlllogariten për periudha të veçanta në varësi të përbërjes familjare, nga një person deri në tre persona. Në këtë drejtim, subjekti ka parashtruar se për vitin 2016 të ardhurat e tij nga paga si prokuror kanë qenë në shumën 1.013.160 lekë, si dhe kursimi i tij përbëhej nga të ardhurat e shtuara në bankë dhe se diferenca mes të ardhurave të tij dhe kursimeve përfaqësonin shpenzimet e tij dhe familjare në shumën prej 813.606 lekësh. Po ashtu, sipas subjektit, për periudhën kur ai dhe bashkëshortja kanë jetuar bashkë (nga data 13.4.2016 deri më 31.12.2016), kjo e fundit ka përfituar të ardhura nga paga dhe leja e lindjes dhe ka tërhequr nga banka shumën prej 555.882 lekësh dhe se shpenzimet e saj për nevoja familjare për vitin 2016 ishin në shumën 441.332 lekë.

2.6.vi Në përfundim, subjekti ka paraqitur në formë tabelare këto të ardhura dhe shpenzime sa më sipër parashtruar, duke shpjeguar se sipas përlllogaritjeve të tij rezulton se të ardhurat e tij kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e jetesës për vitin 2016 dhe justifikohen edhe shpenzimet e bëra për qira banese.

2.6.vii Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka depozituar certifikatë martese dhe certifikatë familjare.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.7 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

2.7.i Lidhur me pretendimin e subjektit për të ardhura të tjera dhe impaktit të tyre në analizën financiare, trupi gjykues çmon se pretendimet e tij nuk mund të merren në konsideratë për shkak se Komisioni, në analizën financiare të kryer, i është referuar deklaratimeve të subjektit për likuiditetet në bankë dhe *cash*, sipas DPV-ve përkatëse, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit⁷ e, për rrjedhojë, nuk mund të prezumojë të ardhura të tjera të cilat nuk janë deklaruar ndër vite. Ky vlerësim është i lidhur po ashtu edhe me faktin e pranuar prej vetë subjektit, se ai nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash*, por vetëm kursime.

2.7.ii Subjekti ka kundërshtuar analizën e Komisionit, duke iu referuar vlerave për të ardhura dhe shpenzime të vitit 2016, ndërkohë që pamjaftueshmëria i rezulton në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting*, pasi ka shtuar vlerën e kursimeve *cash*. Për këtë arsye, analiza financiare është

⁷ Referohuni në pikën 27.12.18 të prg. 27, vendimi nr. 11/2019 (JR); prg. 84, vendimi nr. 19/2019 (JR); prg. 59, vendimi nr. 20/2019 (JR); dhe prg. 31, vendimi nr. 29/2019(JR), të KPA-së.

kryer vetëm për muajin janar të vitit 2017, duke analizuar faktin nëse me të ardhurat e përfituara gjatë këtij muaji mund të shtoheshin kursimet në *cash*, gjithnjë sipas deklarimit të subjektit.

2.7.iii Pretendimi për shpenzimet e jetesës, duke iu referuar përbërjes familjare të subjektit, nuk qëndron, pasi Komisioni, në analizën e kryer për vitin 2016, vërtetë e ka përfshirë bashkëshorten e tij për gjithë vitin kalendarik (pavarësisht se martesë ligjore është në muajin prill), por në të njëjtën kohë ka përfshirë edhe të ardhurat e saj. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, shpenzimet e jetesës janë përlloritur për 3 persona vetëm për dy muajt e fundit pas lindjes së djalit.

2.8 Trupi gjykues, pavarësisht arsytimit të mësipërm, këtë balancë negative, në raport me pretendimet e subjektit, e ka vlerësuar nën çmuarjen e faktit se pamjaftueshmëria financiare në vlerën 122.673 lekë, parë nën dritën e parimit të proporcionalitet të çështjes së rivlerësimit në tërësi, nuk mund të vlerësohet e tillë që të ngrihet në nivelin e ndonjë kualifikimi ligjor për penalizimin e subjektit të rivlerësimit.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa *, vit i prodhimit 1998, në vlerën 250.000 lekë**

3.1 Subjekti i rivlerësimit, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar edhe kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 31.10.2011, me palë shitëse P. C. dhe palë blerëse Juljan Çafka, për blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 250.000 lekë⁸.

3.2 Trupi gjykues ka konstatuar në lidhje me këtë pasuri se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, me përshkrimin “Automjet ‘Mercedes-Benz 250’, viti i prodhimit 1999 (blerë me kurse nga paga). Vlera: 250.000 lekë”.

3.3 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se DPSHTRR-ja⁹ konfirmon automjetin me targa *** në pronësi të z. Juljan Çafka, të përfituar sipas kontratës së shitblerje nr. ***, datë 31.10.2011, me palë shitëse P. C. dhe palë blerëse Juljan Çafka, për blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 250.000 lekë.

3.4 Komisioni kreu analizën financiare në datën e investimit dhe pas përlloritjeve të kryera nuk konstatoi ndonjë problematikë.

3.5 Në përfundim për këtë pasuri, trupi gjykues, sipas fakteve të dala më sipër dhe përlloritjeve financiare të kryera, konkludon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë, si dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme të investojë në blerjen e automjetit dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

4. Në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar kontratë kredie bankare, datë 16.11.2007, të lidhur me “Raiffeisen Bank”, në shumën 250.000 lekë. Afati i shlyerjes: 84 muaj dhe interesi 18 % në vit. Janë paguar këstet mujore deri në mbarim të afatit të kredisë. Shlyer përfundimisht në nëntor të vitit 2014.

⁸ Aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Me shkresat nr. *** prot., datë 11.8.2017, dhe nr. ***prot., datë 8.9.2017, në Aneksin nr. 29, në dosjen e ILDKPKI-së.

4.1 Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar edhe kontratën e kredisë, datë 16.11.2007, me palë kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palë kredimarrëse Juljan Çafka, për marrje kredie në shumën 250.000 lekë¹⁰.

4.2 Trupi gjykues, lidhur me këtë kontratë kredie bankare, ka konstatuar se subjekti rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2008, me përshkrimin “Kredi e marrë në ‘Raiffeisen Bank’, 250.000 lekë, kredi konsumatore”.

4.3 Ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 6.1.2020, ka informuar Komisionin lidhur me kredinë personale të marrë nga subjekti i rivlerësimit, duke vendosur gjithashtu në dispozicion të njëjtën kontratë që ka depozituar edhe subjekti.

4.4 Nga analizimi i dokumentacionit bankar, u konstatua se kjo kredi është marrë një vit përpara se subjekti të emërohej në detyrë dhe është shlyer totalisht/mbyllur në vitin 2014.

4.5 Trupi gjykues, sipas fakteve të dala më sipër, konkludon se deklarimi i subjektit është i saktë, pasi përputhet me dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.

5. Në deklaratën *Vetting*, rubrika “të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar banesë, marrë me qira shtetasit M.S.S., i datëlindjes 9.9.1958, me adresë: lagjja “***”, Gjirokastër, me çmim qiraje mujore 20.000 lekë, sipas kontratës datë 10.2.2014 dhe datë 10.2.2015. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar edhe dokumentacionin mbështetës¹¹:

- Kontratë qiraje, datë 10.2.2014 dhe datë 10.02.2015, me palë qiradhënëse M. S. dhe palë qiramarrëse Juljan Çafka, për marrje me qira banesë në lagjen “***”, Gjirokastër; afati: 1 vit; vlera: 20.000 lekë/muaj.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.12.2015, me palë deklaruese Juljan Çafka dhe M. S., ku ky i fundit deklaron se i ka dhënë banesën e tij me qira shtetasit Juljan Çafka prej datës 10.2.2014 deri më 31.12.2015, kundrejt çmimit 20.000 lekë/muaj, i cili deklaron se ka marrë apartamentin me qira dhe e ka përdorur vetëm për banim, pa i ndryshuar destinacionin.

5.1 Trupi gjykues, lidhur me këtë banesë, fillimisht ka analizuar deklarimet ndër vite të kryera nga subjekti rivlerësimit, ku pas verifikimeve të tyre ka konstatuar se subjekti deklaron adresën e gjendjes civile, si dhe atë të banimit nga deklarimi për herë të parë para fillimit të detyrës së vitit 2008: “***, *Sarandë – shtëpi private me qira e në vazhdim*”.

5.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 subjekti, në rubrikën e detyrimeve financiare, deklaron: “*Qira banese, 15.000 lekë/muaj. Në total 180.000 lekë*”.

5.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 subjekti, në rubrikën e shpenzimeve, deklaron: “*Pagim i çmimit të qirasë, 20.000 lekë/muaj*”.

¹⁰ Aneks nr. 4/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹ Aneks nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

5.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 subjekti, në rubrikën e shpenzimeve, deklaroi: *“Pagim i çmimit të qirasë, 20.000 lekë/muaj”*.

5.5 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 subjekti, në rubrikën e shpenzimeve, deklaroi: *“20.000 lekë/muaj qira banese”*.

5.6 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 subjekti, në rubrikën e shpenzimeve, deklaroi: *“M.S. S., i datëlindjes 9.9.1958, qiradhënës i banesës në lagjen ‘***’, Gjirokastër, çmimi i qirasë mujore 20.000 lekë”*.

5.7 Në pyetësin standard¹² subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me adresat e tij të banimit, si vijon: *“Prej muajit nëntor të vitit 2008, kohë në të cilën kam filluar detyrën, kam jetuar në qytetin e Sarandës në një apartament banimi në pronësi të shtetasit B. E. B. . Në këtë apartament kam qëndruar me qira deri në muajin janar të vitit 2009. Qiraja ka qenë 10.000 (dhjetë mijë) lekë në muaj dhe paratë ia kam dhënë z. B.B. në cash. Po ju paraqes deklaratën noteriale të shtetasit B. B. . Prej muajit shkurt 2009, deri në muajin prill 2010, kam jetuar me qira në një apartament banimi në qytetin e Sarandës, në pronësi të shtetasit S. A. Sh. . Çmimi i qirasë ka qenë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe i është paguar këtij personi çdo muaj në cash. Po ju paraqes deklaratën noteriale të shtetasit S. Sh. . Prej muajit maj 2010 deri në muajin dhjetor 2013 kam jetuar me qira në një apartament banimi në qytetin e Sarandës, në pronësi të shtetasit D.M. R. . Çmimi i qirasë ka qenë 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe i është paguar këtij personi çdo muaj në cash. Po ju paraqes deklaratën noteriale të shtetasit D.R. . Prej muajit dhjetor 2013 deri në muajin shkurt 2014, duke qenë se jam transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër, kam jetuar në një apartament banimi në qytetin e Gjirokastrës, në pronësi të shtetasit A. K. P. . Në këtë apartament banimi kam jetuar pa asnjë detyrim për këtë kohë. Po ju paraqes deklaratën noteriale të shtetasit A.P. . Prej muajit shkurt 2014 deri më sot kam banuar me qira në një apartament banimi në pronësi të shtetasit M.S. S.. Çmimi i qirasë ka qenë 20.000 (njëzet mijë) lekë dhe është paguar çdo muaj në cash. Po ju paraqes deklaratat noteriale të shtetasit M. S. dhe kontratat e qirasë të bëra me këtë person”*.

5.8 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet e qirasë, duke u bazuar në deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore, në pyetësin standard, si dhe në deklaratat e lëshuara prej qiradhënësve. Nga përlllogaritjet e kryera, të pasqyruara edhe në tabelën përmbledhëse në fund të këtij vendimi, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të përballojë edhe shpenzimet e qirasë.

5.9 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar, konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe se subjekti ka pasur mundësi financiare të përballojë shpenzimet e qirasë deklaruar ndër vite.

¹² Pyetësor nr. 1 datë 3.12.2019.

5.10 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se në deklaratën për vitin 2012 subjekti ka deklaruar: *“Shumë e dhënë nga shtetasi K.T., në likuidim të një borxhi që i kam dhënë këtij personi gjatë këtij viti/vlera 50.000 lekë”*. Mbi këtë deklaram, nisur nga fakti i krijimit të një marrëdhënieje (megjithëse në një shifër minimaliste) pasurore me një të tretë, Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionet publike dhe sistemin bankar për të identifikuar pasuritë dhe/ose likuiditetet për llogari të këtij të fundit. Nga verifikimi i korrespondencave nuk kanë rezultuar *indicie* që të implikojnë subjektin e rivlerësimit.

5.11 Ndërkohë, pasi është pyetur¹³ në lidhje me marrëdhënien me këtë shtetas, arsyet e dhënies së kësaj shume, si dhe nëse në ushtrimin e detyrës së tij kishte hetuar çështje lidhur me këtë person, subjekti ka deklaruar: *“[...] shtetasi K. T. është i biri i J. dhe i F., i datëlindjes 24.9.1977, banues në Përmet. Babai i K., shtetasi J. T., është vëllai i nënës sime, të quajtur O. Ç. (T.). Pra, Klodjani është djali i dajos tim, kushëri i parë imi. Shumën e parave prej 50.000(pesëdhjetë mijë) lekësh shtetasi K. T. ma kërkoi për nevojat e tij familjare. Gjatë ushtrimit të detyrës time si prokuror, deklaroj se nuk kam hetuar, nuk kam mosfilluar, nuk kam pushuar, nuk kam dërguar për gjykim çështje në ngarkim të shtetasit K. T. dhe as çështje të vëna në lëvizje nga ky person”*. Subjekti ka depozituar: certifikatë trangu familjar për shtetasit J. T. e O. T.; certifikatë trangu familjar për shtetasin K. T.; certifikatë trangu familjar për shtetasin Juljan Çafka; deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.7.2021, e shtetasit K. T.; si dhe vërtetim nr. *** prot., datë 16.7.2021, të spitalit të Përmetit, ku pasqyrohet punësimi i këtij personi.

5.12 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar, konkretisht nga certifikata e gjendjes familjare, datë 16.7.2021, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Këlcyrë, ka konstatuar se provohet lidhja familjare (motër e vëlla) midis shtetasve O. T. dhe J. T. dhe më tej edhe me subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, sipas deklaratës noteriale datë 16.7.2021, shtetasi J. T. ka deklaruar marrjen e shumës për nevoja familjare, si dhe shlyerjen e saj brenda vitit, në dy këste. Në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm në ushtrimin e detyrës me këtë shtetas, subjekti ka deklaruar se nuk ka hetuar ndonjëherë ndonjë çështje me këtë shtetas, ndërsa ka depozituar edhe vërtetimet përkatëse nga të dy prokuroritë e rretheve Sarandë dhe Gjirokastër, ku cilësohet ky fakt.

5.13 Trupi gjykues, në përfundim për këtë çështje, bazuar në faktet dhe rrethanat e sipërcituara të dala nga hetimi, konkludon se nuk identifikohen problematika lidhur me këtë marrëdhënie pasurore të kryer dhe të përfunduar brenda të të njëjtit vit kalendarik dhe me një familjar.

5.14 Komisioni, në kuadër të një hetimi të plotë: (i) ka verifikuar sistemin *online* multifunksional të ASHK-së, ku ka konstatuar se nuk ekzistojnë pasuri në emër të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me të; (ii) ka mbajtur korrespondencë me FSHU-në dhe UKT-në¹⁴, ku ka rezultuar se këto shoqëri nuk kanë konfirmuar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe/ose bashkëshortes së tij kontrata të lidhura për shërbime të energjisë elektrike dhe për shërbime ujësjellës-kanalizime; si dhe (iii) ka verifikuar të dhënat e regjistrimit noterial, dërguar nga Ministria e Drejtësisë, në lidhje

¹³ Me e-mail-in e datës 15.7.2021, përgjigje po në e-mail-in në datën 19.7.2021.

¹⁴ Shkresa të administruara në dosjen e Komisionit.

me marrëdhëniet kontraktore të lidhura nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose bashkëshortja e tij, nga ku nuk rezultuan akte noteriale të ndryshme nga ato të evidentuara gjatë hetimit administrativ.

Deklarimi i pasurive të bashkëshortes së subjektit, znj. A. Ç.

6. Kursime page gjatë punës si bankiere personale, të vendosura në depozitë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 471.172 lekë

6.1 Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentacionin mbështetës¹⁵:

- Pasqyrë llogarie datë 17.10.2016, nga “Raiffeisen Invest” për znj. A. Ç., sipas së cilës gjendja e llogarisë në datën 17.10.2016 është 471.172 lekë.

6.2 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2020, informon mbi llogaritë e shtetases A.C. dhe nga statement identifikohen shumat e kaluara në fond investimi prej vitit 2012.

6.3 “Raiffeisen Invest”¹⁶, me *e-mail*-in e datës 26.6.2019, konfirmon llogari në emër të znj. A. Ç., me gjendje në datën 26.1.2017 në vlerën 461.585 lekë.

6.4 Trupi gjykues, duke analizuar dokumentacionin bankar, ka vërejtur se vlera e gjendjes së deklaruar nga subjekti nuk përputhej me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”. Kjo mospërputhje lidhej me faktin se gjendja e deklaruar prej saj i referohej një date tjetër nga ajo e depozitimit të deklaratës *Vetting*. Nga analiza financiare e kryer, Komisionit nuk i kanë rezultuar problematika mbi mundësinë e krijimit të kursimeve të bashkëshortes së subjektit, sikurse do të trajtohet/arsyetohet në vijim në pikën nr. 7 të këtij vendimi.

6.5 Në përfundim, trupi gjykues, pas verifikimit të deklaramit të subjektit në raport me të dhënat bankare të administruara, ka konstatuar se përputhet deklarimi i subjektit, duke konkluduar se ka deklaruar saktë këtë llogari bankare, si dhe bashkëshortja e tij ka pasur mundësi ta kursejë shumën e deklaruar.

7. Kursime page cash në vlerën 500.000 lekë

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 deklaroi kursime page *cash* në vlerën 500.000 lekë.

7.1 Ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore¹⁷ në datën 13.4.2016. Gjatë hetimit, Komisionit i rezultoi se bashkëshortja e subjektit: (i) ka filluar të sigurojë të ardhura nga punësimi¹⁸ prej tetorit të vitit 2011; (ii) ka investuar në blerjen e një automjeti; si dhe (iii) ka marrë dy kredi, ku njëra prej tyre ka shërbyer për blerjen e automjetit.

7.2 Komisioni kreu analizën financiare për të konkluduar nëse bashkëshortja e subjektit kishte mundësi të kursente, duke përfshirë çdo investim/shpenzim të identifikuar gjatë hetimit administrativ.

¹⁵ Aneks nr. 4/6, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Aneks nr. 25, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁷ Certifikatë martesë, depozituar në pyetësorin nr. 1, datë 3.12.2019.

¹⁸ Shkresë nr***prot., datë 6.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

7.3 Nga përlllogaritjet e kryera, trupi gjykues konstatoi se bashkëshortja e subjektit ka pasur mundësi të kursejë shumën 500.000 lekë, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera, për rrjedhojë nuk evidenton problematika lidhur me këtë likuiditet.

8. Tokë bujqësore me sip. 9.400 m², në bashkëpronësi të familjes bujqësore, me vendndodhje: fshati K., Njësia Administrative ***, Bashkia Këlcyrë, në bashkëpronësi në tërësi (familje bujqësore), me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***.

8.1 Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar dokumentacionin përkatës¹⁹:

- Aktin e marrjes së tokës nr. *** regj., sipas së cilës familjes së shtetasit F. C. i jepet tokë në pronësi me sipërfaqe totale 9.700 m² (në akt pasqyrohet sipërfaqja 9.400 m² arë dhe 300 m² truall), në fshatin K. .

8.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 bashkëshortja e subjektit ka deklaruar *tokë bujqësore në bashkëpronësi të familjes bujqësore, me vendndodhje fshati K., Njësia Administrative ***, Bashkia Këlcyrë, bashkëpronësi në tërësi (familje bujqësore), me sip. 9.400 m², me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. ***.*

8.3 Trupi gjykues, lidhur me këtë pasuri, nën konstatimin e fakteve ku provohet se: (i) është përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr***; dhe (ii) bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar këtë pasuri si në deklaratën periodike vjetore, edhe në atë *Vetting* – konkludon se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

9. Automjeti i tip “Fiat Punto”, me targa ***, viti i prodhimit 2003, blerë në tetor të vitit 2014, në vlerën 250.000 lekë. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.10.2014, me palë shitëse H. N. dhe palë blerëse A.C., për blerje automjeti tip “Fiat Punto”, me vlerë 250.000 lekë²⁰.

9.1 DRTSHTRR-ja Gjirokastër²¹, me *e-mail*-in datë 26.6.2019, konfirmon automjetin me targa ***, në pronësi të shtetasës A. C. dhe njëkohësisht ka bashkëlidhur kontratën e shitblerjes nr***, datë 18.10.2014, me palë shitëse H. N. dhe palë blerëse A. C., për blerje automjeti tip “Fiat Punto”, në vlerën 250.000 lekë.

9.2 Gjatë hetimit ka rezultuar se shtetasja A. C. në datën 16.10.2014 ka marrë kredi në “Raiffeisen Bank”, në shumën 300.000. Ndërsa në datën 17.10.2014, pas disbursimit të kredisë, kjo shtetase ka transferuar nga llogaria e saj bankare shumën 260.000 lekë për shtetasin Sh. S. H., me përshkrimin “Transferim i shumës së blerjes së automjetit”.

9.3 Komisioni e ka pyetur²² subjektin lidhur me këtë transaksion, pasi nuk përputhej emri i blerësit me përfituesin e shumës. Në përgjigje, bashkëshortja e subjektit ka sqaruar se: “*Duke qenë se*

¹⁹ Aneks nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Aneks nr. 4/8, në dosjen e ILDKPKI-së.

²¹ Aneks nr. 29, në dosjen e ILDKPKI-së.

²² Pyetësor nr. 2 datë 15.6.2021.

*punoja në 'Raiffeisen Bank'/Agjencia Këlcyrë dhe kisha problem transportin rrugor të përditshëm për të shkuar në banesën time në fshatin ***, kam biseduar me prindërit dhe vendosa të blej një automjet. Për këtë qëllim kisha bërë edhe kursin dhe isha pajisur me leje drejtimi automjeti, kategoria B. Në bisedë me prindërit, ata më thanë se personi i cili mund të interesohej për të gjetur një automjet ishte kushëriri i parë i babait tim F.C., shtetasi Sh. H., i cili banonte dhe banon në qytetin e Fierit. Shtetasi Sh. H. dhe babai im F. C.janë djem tezesh mes tyre. Pasi kemi biseduar me Shkëlqimin nëpërmjet telefonit, pas njëfarë kohe ai na tha se e kishte gjetur automjetin që e shiste një person me të cilin kishte biseduar. Ai na tha edhe çmimin dhe karakteristika të mjetit. Vendosëm që ta blija mjetin dhe për këtë arsye i dërgova edhe shumën e parave Shkëlqimit, me qëllim që t'ia jepte shitësit. Përveç çmimit prej 250.000 lekësh i kam dërguar Shkëlqimit edhe vlerën prej 10.000 lekësh për t'u paguar shpenzimet e noterizimit dhe për disa shpenzime të vogla për të cilat kishte nevojë makina. Të nesërmen kemi nënshkruan kontratën e shitjes së mjetit, ndërkohë shitësi i kishte marrë paratë e çmimit nga Shkëlqimi, siç përmendet edhe në kontratën e shitjes”.*

9.4 Trupi gjykues lidhur me këtë çështje, nën konstatimin e fakteve se: (i) deklarimi i bashkëshortes së subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR-së Gjirokastër; (ii) bashkëshortja e subjektit, në kohën e blerjes së kësaj pasurie (viti 2014), nuk ka qenë person i lidhur me subjektin, pasi martesë e tyre daton në vitin 2016; dhe (iii) nga analiza financiare e kryer, e trajtuar edhe më sipër, nuk ka rezultuar në pamjaftueshmëri financiare – konkludon se bashkëshortja e subjekti ka kryer deklarim të saktë, si dhe ka pasur mundësi financiare me burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

10. Në rubrikën “detyrime financiare” bashkëshortja e subjektit ka deklaruar kontratë huaje bankare, datë 16.10.2014, me “Raiffeisen Bank”, në shumën 300.000 lekë, me afat shlyerjeje 24 muaj, me normë interesi 4.86 % në vitin e parë, e shlyer në tetor të vitit 2016. Subjekti, së bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar kontratë kredie datë 16.10.2014, me palë kredidhënëse “Raiffeisen Bank” dhe palë kredimarrëse A. C., për marrje kredie në vlerën 300.000 lekë²³.

10.1 Trupi gjykues, lidhur me këtë kontratë huaje, ka konstatuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr***prot., datë 6.1.2020, ka konfirmuar kredi në emër të shtetases A. C., datë 17.10.2014, në shumën 300.000 lekë. Sipas kontratës së kredisë, qëllimi i dhënies së saj është për përdorim personal. Nga *statement*-i bankar vihet re se kjo kredi është shlyer përfundimisht në tetor të vitit 2016.

10.2 Në përfundim, trupi gjykues, pas verifikimit të deklarimit të bashkëshortes së subjektit në raport me të dhënat bankare të administruara, ka konstatuar se përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar.

11. Kontratë huaje bankare, datë 22.1.2013, me “Raiffeisen Bank”, në shumën 160.000 lekë, me afat shlyerjeje 1 vit, me normë interesi 7 % në vit, e shlyer në janar të vitit 2014. Subjekti, së

²³ Aneks nr. 4/10, në dosjen e ILDKPKI-së.

bashku me deklaratën *Vetting*, ka depozituar nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank” për shtetasen A.C., ku në datën 22.1.2013 disbursohet kredi në vlerën 160.000 lekë²⁴.

11.1 Trupi gjykues, lidhur me këtë kontratë huaje, ka konstatuar se “Raiffeisen Bank²⁵” ka konfirmuar kredi në emër të bashkëshortes së subjektit A.C.²⁶, në datën 22.1.2013, në shumën 160.000 lekë. Sipas kontratës së kredisë, qëllimi i saj është për përdorim personal. Nga *statement*-i i bnkar vihet re se kjo kredi është shlyer përfundimisht në janar të vitit 2014.

11.2 Në përfundim, trupi gjykues, pas verifikimit të deklaratimit të bashkëshortes së subjektit në raport me të dhënat bankare të administruara, ka konstatuar se përputhet deklarimi me dokumentacionin e administruar.

²⁴ Aneks nr. 4/9, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵ Shkresë nr. ***prot., datë 6.1.2020.

²⁶ Mbiemri i vajzërisë pas martesë, Çafka.

Analiza financiare 2008 - 26.01.2017

Nr	Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	26.01.2017
1	TË ARDHURA	186 159	527 865	432 333	1 001 641	1 042 679	1 070 815	990 775	994 757	1 124 765	1 109 014	2 321 120	84 430
	Të ardhura nga paga Subjekti	186 159	527 865	432 333	1 001 641	1 042 679	1 070 815	990 775	994 757	1 124 765	1 109 014	1 013 160	84 430
	Të ardhura nga paga Bashkëshortja	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	807 960	
	Kursime bashkëshortja	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	500 000	
2	SHPENZIME	-	141 874	219 674	341 791	369 087	394 813	384 244	384 163	538 711	552 454	1 086 659	78 773
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	-	136 620	136 620	136 620	136 620	136 620	141 024	141 024	219 998	224 276	509 366	58 773
	Shpenzime qiraje	-	-	20 000	142 000	168 000	180 000	180 000	180 000	200 000	240 000	240 000	20 000
	Shpenzime TIMS	-	-	-	-	-	13 830	-	-	61 648	48 178	145 681	
	Shpenzime kedia (250.000 lekë) 16.11.2007	-	(244 746)	63 054	63 171	64 467	64 363	63 220	63 139	57 064	-	-	
	Hua marr vëllait	-	-	-	-	-	-	-	-	-	40 000	-	
	Shpenzime kredia RFZ 2014 (300.000 lekë)											131 612	
	Shpenzime arredimi											60 000	
3	PASURI	(58)	135 960	(134 603)	135 039	120 945	122 717	180 714	140 972	560 957	(336 480)	1 253 424	128 330
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme												
	Automjet Mercedes Benz targa ***	-	-	-	-	-	250 000	-	-	-	-	-	
	Automjet Fiat/Punto *** (blerë 18.10.2014) 250.000 lekë (B/SH)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
	<i>Ndryshim Likuiditeti</i>	(58)	135 960	(134 603)	135 039	120 945	(127 283)	180 714	140 972	560 957	(336 480)	1 253 424	128 330
	DIFERENCA (1-2-3)	186 217	250 031	347 263	524 810	552 647	553 285	425 817	469 622	25 097	893 040	-18 962	-122 673

B. KONTROLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku në përputhje me pikën 2 të po këtij neni ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Juljan Çafka*.

2. Pas kërkesës²⁷ së Komisionit për përditësimin e raportit, DSIK-ja, në raportin e radhës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 9.12.2020, të KDZH-së, ka informuar Komisionin si vijon:

2.i Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për implikim në veprimtari korruptive të funksionarit të drejtësisë, në rastin konkret të një prokurori, nëpërmjet premtimit apo kërimit të drejtpërdrejtë apo tërthorazi të çfarëdolloj përfitimi të parregullt për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën e tij funksionale, cenon drejtpërsëdrejti pastërtinë e figurës, çfarë përmbush plotësisht përcaktimet e germave “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016, ku z. Juljan Çafka vlerësohet si individ i mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale.

2.ii Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit Juljan H. Çafka, nga përshtatshmëri në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2.iii Komisioni i kërkoi Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë depozitimin e disa fashikujve penalë, shqyrtimi i të cilave referohet tek rivlerësimi profesional i subjektit, ku arsyetohet mbi faktet e rrethanat e hetimit për çdo rast.

2.iv Në vijim të këtij raporti dhe çështjeve të trajtuara, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime për sa rezultonte në tërësi në raportin e përditësuar të DSIK-së, ndërthurur edhe me të dhënat e dosjeve penale²⁸.

2.v Subjekti i rivlerësimit, në qëndrimin e tij gjatë procesit, ka kundërshtuar përfundimin e nxjerrë nga DSIK-ja në raportin e përditësuar për kontrollin e figurës, duke u shprehur se: *“Gjatë ushtrimit të detyrës sime, në asnjë rast nuk jam ndikuar nga faktorë të jashtëm dhe kam zbatuar me korrektësi ligjin, duke i zgjidhur dhe përfaqësuar drejt çështjet penale të cilat më janë caktuar t’i ndjek”*. Sipas parashtrimeve të subjektit, ai gëzon reputacion të mirë për shkak të korrektësisë dhe faktit se i është referuar gjithmonë zbatimit të ligjit sa më drejt: *“Informacionet për përfshirje në veprimtari korruptive janë të pavërteta dhe aq e vërtetë është kjo, sa vetë DSIK-ja, fillimisht në raportin e parë, nuk i ka konsideruar”*. Lidhur me çështjet konkrete subjekti ka shpjeguar²⁹ se

²⁷ Kërkesë nr. ***, datë 2.10.2020.

²⁸ Referuar konkluzioneve në seksionin përkatës.

²⁹ Referoni qëndrimin e subjektit sipas çdo çështjeje të arsyetuar në kriterin profesional.

vendimmarrjet kanë qenë të drejta, bazuar në faktet e rezultuara dhe në provat e marra. Gjithashtu ka parashtruar se në qëndrimin e tij nuk ka qenë i ndikuar nga asnjë çështje apo faktorë të jashtëm, por si në çdo funksion objeksionet mund të akumulohen të gjitha në mënyrë të padrejtë dhe të kanalizohen në mënyrë të padrejtë. Subjekti nuk pretendon për tendencë nga organet shtetërore, pasi edhe ata zbatojnë detyrën, porse për shkak të qëndrimit ligjor ka edhe kundërgoditje, të cilat vijnë nga persona/subjekte që kanë interesa të kundërta në procese.

2.vi Trupit gjykues, në tri dosjet e shqyrtuara lidhur me këtë kriter, i rezultoi se: (i) në një rast nga verifikimi i akteve të administruara subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokuror i kësaj çështjeje në asnjë fazë të hetimit; (ii) mbi procedimin penal nr. *** të vitit 2016, regjistruar për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. K., subjekti ka ndërmarrë veprimet e plota hetimore dhe çështja është dërguar për gjykimin e të pandehurve, duke kërkuar “Deklarimin fajtor të tyre për veprën penale të ‘vjedhjes’, parashikuar nga nenet 134/2³⁰ dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin me 6 (gjashtë) muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimtar me 4 (katër) muaj burgim dhe në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin për pjesën e pavuajtur dhe dënimin e të pandehurit me punë në interes publik, në afatin 60 orë”, si dhe vlerësimi i çështjes në tërësi gjendet në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 134 të Kodit Penal, “vjedhja e pasurisë”, ku parashikohet shprehimisht (neni 134/2) se: “[...] Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”; (iii) mbi procedimin penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit K. Sh., akuzuar për veprën penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal, ku subjekti ka disponuar me pushimin e çështjes, në tërësi të rrethanave dhe fakteve të pasqyruara nuk u arrit në një konkluzion për provueshmërinë e tyre.

2.vii Trupi gjykues, lidhur me vlerësimin e pastërtisë së figurës së subjektit dhe shkallës së besueshmërisë së tij, referuar dispozitave ligjore për kontrollin e figurës, kreu V i ligjit nr. 84/2016, bazuar në analizën ligjore dhe rrethanat faktike të çështjeve konkrete, çmon se: (i) në nivelin në të cilën gjenden provat e administruara në dosjet hetimore nga Komisioni; (ii) faktet e rezultuara nga hetimi; dhe (iii) në nivelin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht dyshimeve të ngritura – në përfundim nuk arriti në provueshmërinë e tyre. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se nuk gjen vend zbatimi i dispozitave ligjore për masë penalizuese brenda përcaktimeve ligjore të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

2.viii Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij nuk evidentoi ndonjë *indicie* apo fakt tjetër që mund të mbështeste këto dyshime dhe, si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Çafka, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

³⁰ Në neni 134/2 është parashikuar shprehimisht: “[...] Vjedhja e pasurisë [...] Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti³¹ për këtë vlerësim është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë raport analizohen të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) të 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; si dhe (iii) të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i cili është i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Analiza e gjetjeve³²

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formulari i vetëvlerësimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, Sektori i Protokoll-Arkivit, si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Juljan Çafka, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Menjëherë pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Respekton afatet ligjore procedurale lidhur

³¹ Raporti nr*** prot., datë 30.7.2020.

³² Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

me vlerësimin e sekuestrimeve të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore; mbi rastet e arrestit/ndalimit për vlerësimin e tyre dhe paraqitjen e kërkesës në gjykatë; si dhe mbi përfundimin e hetimeve. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon përgjithësisht saktë normën ligjore të zbatueshme. Konstatohet se përgjithësisht arsyetimi i zgjidhjes ligjore përkon me dispozitën procedurale të vendosur në pjesën konkluduese.

Në përgatitjen e akteve, subjekti i rivlerësimit respekton dispozitat procedurale penale, por edhe të urdhrit nr. ***, datë 5.9.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”; urdhrit nr. ***, datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallëve të para”; udhëzimit nr. ***, datë 4.12.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për shpenzimet procedurale”; udhëzimit nr. ***, datë 21.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar.

Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Juljan Çafka, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale, në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka shfaq aftësi në arsyetimin ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se prej tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provat e mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në formularin e vetëdeklarimit rezulton se për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 879 çështje, që konsiderohet një ngarkesë relativisht e lartë. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në shortin e zhvilluar në datën 21.9.2018 në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për përzgjedhjen e 5 dokumenteve ligjore, për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, rezulton se prokurori Juljan Çafka tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore³³ të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara.

Në analizë të të dhënave, konstatohet se subjekti Juljan Çafka ka treguar aftësi shumë të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuar dhe numrin total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

³³ Dosja nr. 1 – kohëzgjatja 13.10.2015 – 30.10.2015 (17 ditë); dosja nr. 2 – kohëzgjatja 18.3.2015 – 6.6.2015 (2 muaj e 19 ditë); dosja nr. 3 – kohëzgjatja 22.4.2015 – 15.10.2015 (5 muaj e 23 ditë); dosja nr. 4 – kohëzgjatja 22.7.2014 – 24.9.2014 (2 muaj e 2 ditë); dosja nr. 5 – kohëzgjatja 6.4.2014 – 30.6.2014 (2 muaj e 24 ditë).

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet se nga ana e tij veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzimore u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme dhe duke konkluduar në një vendimmarrje. Lidhur me njoftimet e vendimmarrjeve, konstatohet se në përgjithësi është respektuar detyrimi për t'i kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit. Në dosjet për gjykim, në fashikullin e prokurorit, konstatohet se ndodhen të administruara edhe listat e dëshmitarëve, konkluzionet me shkrim të paraqitura në gjykatë, si dhe apelet në rastet kur ka, duke e bërë qartësisht të lexueshme zgjidhjen e një çështjeje.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga ankesat e analizuar rezultoi se nuk janë gjetur të dhëna që të tregojnë se ka kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Në ankesat e paraqitura, shtetasit kanë paraqitur pretendimet e tyre, kryesisht të lidhur me qëndrimin e tyre ndaj vendimmarrjes së prokurorit, të cilat janë shqyrtuar nga organi përkatës, duke dalë me një përgjigje/vendim.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas shkresës me nr. *** prot., datë 28.9.2018, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, e lidhur me kohën e punës, për prokurorin Juljan Çafka nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të prokurorit Juljan Çafka. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të

barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit prokurorit Juljan Çafka për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

5. Në lidhje me verifikimin e ankesave, masave disiplinore dhe vlerësimeve, nga verifikimi i të dhënave të prokurorive të rretheve gjyqësore³⁴, nuk rezulton që subjekti Juljan Çafka: (i) të ketë masa disiplinore lidhur me punën e kryer; (ii) të ketë të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta; (iii) të ketë të dhëna të dokumentuara (biseda, foto, vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike) të përfshirjes së tij në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale); (iv) të ketë pasur ndaj tij procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme; (v) të ketë qenë person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar në procedime penale të hetuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë³⁵; si dhe (vi) të jetë regjistruar procedim penal apo kallëzim penal nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër³⁶.

6. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në raportin e tij, ka pasqyruar se ndaj subjektit të rivlerësimit ka pasur: (i) dy kallëzime nga shtetasja E. A., me të njëjtin objekt (gjithnjë nën akuzën e shpërdorimit

³⁴ Me shkresat: nr. *** prot., datë 8.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet; nr. *** prot., datë 2.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. *** prot., datë 1.10.2018 dhe nr. *** prot., datë 12.11.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. ***prot., datë 3.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat; nr. *** prot., datë 11.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; nr. *** prot., datë 8.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë; nr. ***prot., datë 4.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. *** prot., datë 8.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, nr. ***prot., datë 4.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. ***prot., datë 3.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. ***prot., datë 1.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës; nr. ***prot., datë 3.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini; nr. *** prot., datë 29.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; nr. ***prot., datë 27.11.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr. ***prot., datë 3.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; nr. *** prot., datë 3.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr. ***prot., datë 30.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; nr. *** prot., datë 12.10.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. ***prot., datë 7.12.2018, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; të dhënat nga Sekretaria Sekrete (shkresa nr. ***prot., datë 12.11.2018), si dhe burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme (shkresa nr.***prot., datë 28.9.2018).

³⁵ Me shkresën nr. ***prot., datë 5.10.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

³⁶ Shkresat nr. ***prot., datë 21.11.2018, dhe nr. ***prot., datë 17.12.2018.

të detyrës), për të cilët është vendosur mosfillimi i tyre; (ii) një kallëzim nga shtetasi A.S., ku po ashtu, nga prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë është vendosur mosfillimi; (iii) një kallëzim nga shtetasi V. B., për të cilin Komisioni ka zgjeruar hetimin dhe është shprehur në detaje si vijon, në rubrikën e Rivlerësimit Profesional, si dhe janë depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme, përkatësisht: (iv) një ankesë nga shtetasi M. V. dhe (v) një ankesë nga shtetasja Vera Gega, për të cilët ky institucion, gjithashtu ka kthyer përgjigjet përkatëse.

C/I. Rivlerësimi profesional

7. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar edhe raporti i Vlerësimit Profesional për këtë subjekt rivlerësimi, përgjithësisht, sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk vërejtí problematika.

8. Komisioni, nga analizimi i ankesave të ushtruara ndaj subjektit të rivlerësimit, të trajtuara në raportin e vlerësimit profesional, të cilat përgjithësisht referojnë kallëzime ndaj subjektit nën akuzën e shpërdorimit të detyrës, pas pretendimeve se prej tij janë kryer shkelje në rastet e çështjeve të hetuara në ngarkim të kallëzuesve: (i) kërkoi fashikullin penal që i përket procedimit penal nr. *** të vitit 2015, regjistruar mbi kallëzimin e bashkëshortes së shtetasit V. B., hetuar nga subjekti i rivlerësimit, për të konkluduar lidhur me pretendimet e këtij shtetasi (marrë si i pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal dhe dërguar për gjykim në datën 27.1.2017), ku renditen disa shkelje në adresë të subjektit, të cilat sipas tij konsistojnë: në mungesën e kompetencës tokësore të ushtrimit të ndjekjes penale nga ana e prokurorit, pasi vepra penale është kryer dhe pasojat kanë ardhur në qytetin e Vlorës; dërgimin e çështjes në gjykatë pa e njohur kallëzuesin në cilësinë e të pandehurit dhe mbrojtësin me aktet e dosjes; nuk ka prova shpresore apo me dëshmitarë në arritjen e konkluzionit të prokurorit se ai, së bashku me ish-bashkëshorten, kanë përfutur një shumë parash të caktuara në një periudhë kohe; prokurori arrin në mënyrë të gabuar në konkluzionin se motra e kallëzuesit nuk ka pasur mundësi financiare për t'i dhënë hua kallëzuesit; si dhe (ii) i kërkoi³⁷ subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimet e sipërcituara.

8.1 Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“Mbi bazën e akteve të referuara nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër ka regjistruar procedimin penal nr. ***, në datën 16.10.2015, në ngarkim të shtetasit V. B., për veprën penale të ‘mashtimit’, parashikuar nga neni 143/1 i Kodit Penal. Hetimet kanë nisur mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit A.B., e cila pretendonte se: (a) së bashku me ish-bashkëshortin kanë ndërtuar një objekt në qytetin e Vlorës, me kursimet që kishin prej 54.000(pesëdhjetë e katër mijë) euro, në vitin 2005; (b) bënë kërkesë në Zyrën e ALUIZNI-t Vlorë për legalizim të objektit; (c) në datën 7.7.2012, V. bëri kërkesëpadi në Gjykatën e Tiranës për divorcim nga kallëzuesja; (ç) në datën 11.7.2012 shtetasi V.B. shkoi tek noter B. Xh. në qytetin e Gjirokastrës, së bashku me motrën e tij V.K. dhe nënshkruan një deklaratë*

³⁷ Me pyetësin nr. 3, datë 1.7.2021.

*noteriale sikur motra V. i ka dhënë vëllait të saj V. shumën prej 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro për ndërtimin e objektit dhe do të përfitonte edhe 20.000 euro si personi që do të ndiqte punimet; (d) deklarata e sipërcituar është përdorur në gjykimet civile për ndarje të pasurisë mes bashkëshortëve; (dh) rezulton se shtetases V.K. i janë njohur të drejtat mbi objektin me vendimin nr. ***, datë 23.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Mbi këto fakte nga ana ime janë nisur hetimet, duke qenë objekt verifikimi: (a) ekzistenca e deklaratës noteriale; (b) vërtetësia e përmbajtjes së saj; (c) aftësia paguese e shtetases V. K.; (ç) praktika fillestare e deklarimit tek ALUIZNI; (d) ana subjektive e veprimeve të shtetasit V.B. . Lidhur me kompetencën tokësore, nga ana ime është vlerësuar se mekanizmi i përfitimit të paligjshëm kishte lidhje të drejtpërdrejtë me veprime të kryera në qytetin e Gjirokastrës, e konkretisht me përpilimin e deklaratës noteriale. Kjo deklaratë noteriale, sipas bindjes sime që u përforcua mbi bazën e provave të marra, ishte e rreme, për arsye se nga verifikimi pasuror i kryer në banka nuk justifikohet shuma prej 150.000 euro e dhënë borxh vëllait të saj V.B. . Në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se kompetenca përcaktohet në radhë të parë nga vendi ku është kryer veprimi ose ka ardhur pasoja. Rezulton se veprimi themelor në çështjen konkrete është kryer në qytetin e Gjirokastrës, kurse pasoja ka ardhur në qytetin e Vlorës. Në doktrinë dhe në praktikën gjyqësore është mbajtur qëndrimi se në rastin e veprave distancionale, kompetenca mund t'i përkasë si vendit ku kryhet veprimi, ashtu edhe vendit ku vjen pasoja. Në këto kushte, kam vlerësuar se kompetenca tokësore i përket Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër. Lidhur me pretendimin se shtetasi V. B. nuk është njohur me akuzën e materialet e çështjes, ky pretendim nuk qëndron. Është zbatuar procedura e rregullt, është njohur me akuzën e aktet dhe është pyetur si i pandehur. Lidhur me provueshmërinë e fakteve kam krijuar bindjen mbi të dhënat e marra se veprimet e shtetasit V.B. janë kryer me qëllim zhveshjen nga pronësia e ish-bashkëshortes së tij. Lidhur me aftësinë paguese të motrës së tij V. K., nga verifikimi pasuror i kryer nuk u vërtetua aftësia e saj për dhënien e shumës 150.000 euro. Kjo rrethanë, e vlerësuar edhe me kohën e përpilimit të deklaratës, që ishte pesë ditë pas depozitimit të padisë së divorcit, fakti që referonte post factum në veprime të kryera më parë, u vlerësua si e vërtetuar”.*

8.2 Subjekti ka depozituar fashikullin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015, si dhe vendimin nr. ***, datë 10.4.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, sipas të cilit është vendosur “Shpallja e moskompetencës” dhe dërgimi i akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështjeje.

8.3 Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar (vendimit gjyqësor), i ka kërkuar sërish shpjegime subjektit mbi zbatimin në këtë rast të nenit 76/1 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ngriheshin dyshime se ishte vepruar në kundërshtim me kushtet e moskompetencës tokësore në hetimin e kësaj çështjeje.

8.4 Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë kërkim, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse ishte përgjigjur më parë gjatë hetimit, duke qartësuar se ka qenë vlerësimi dhe bindja e tij se bazuar në

nenin 76³⁸ të Kodit të Procedurës Penale, kompetenca tokësore i përkiste Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pasi mekanizmi i përfitimit të paligjshëm lidhej drejtpërdrejt me përpilimin e deklaratës noteriale në qytetin e Gjirokastrës, e cila ishte e rreme, fakt ky që ishte përforcuar mbi bazën e provave të marra, nga verifikimi pasuror i kryer në banka, ku rezultonte se nuk justifikoheshin shuma 150.000 euro, e dhënë hua shtetasit V. B. nga motra e tij.

8.5 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje, nga verifikimi dhe analizimi i akteve të administruara në dosje, së pari konstatoi se pretendimet e denoncuesit për dërgimin e çështjes në gjykatë pa e njohur kallëzuesin (në cilësinë e të pandehurit) dhe mbrojtësin me aktet e dosjes, nuk qëndrojnë. Në këtë drejtim, nga aktet në dosje rezultoi se denoncuesi V. B. është njohur me akuzën dhe është pyetur si i pandehur³⁹. Në vijim, trupi gjykues, në trajtimin e këtij rasti, nënvizon faktin se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar dhe më tej ka kryer veprime të plota hetimore që shfaqin aftësi për të mbledhur prova për zbardhjen e së vërtetës në këtë çështje, objekt hetimi. Lidhur me çështjen e kompetencës tokësore, trupi gjykues, në dinamikën e plotë të çështjes objekt hetimi administrativ, konsideron: (i) rrethanat faktike të saj, ku kryesisht provohet se deklarata noteriale që lidhet me mekanizmin e përfitimit të paligjshëm është nënshkruar në qytetin e Gjirokastrës; (ii) logjikën juridike interpretative të nenit 76 të Kodit të Procedurës Penale, përdorur nga subjekti në vlerësim të radhës së veprimeve të kryera; por edhe (iii) bindjen e brendshme të cilësuar prej tij, si pjesë e evidente logjike të përdorur në arsyetim. Nga leximi i literaturës në nenin 76 të Kodit të Procedurës Penale vërehet se prokurori i çështjes ka konstatuar dhe vlerësuar se fakti i ndodhur në qytetin e Gjirokastrës gjendet i materializuar në deklaratën noteriale të nënshkruar para noterit publik po në këtë qytet. Po ashtu, në interpretim të kësaj dispozite, duket se vepra penale e merr zanafillën e saj pikërisht nga veprimi noterial, vërtetësia e të cilit shtrin pasojat tek palët. Në këto rrethana, proporcionalisht por edhe ligjërisht logjika dhe bindja e brendshme e subjektit shkojnë paralelisht me vendimmarrjen e gjykatës për të cilën është vendosur moskompetenca⁴⁰, pra duket se nuk konkurrojnë me njëra-tjetrën. Kjo, për faktin se gjykata në vendimmarrjen e saj nuk përjashton deklarin noterial por cilëson të tjera rrethana për të adresuar moskompetencën, si vendndodhjen e pasurisë (objekt konflikti mes ish-bashkëshortëve) në qytetin e Vlorës apo edhe aplikimin dhe legalizimin e saj po në këtë qytet, duke pasqyruar në arsyetimin e vendimit numrin e veprimeve të kryera në qytetin e Vlorës, krahasimisht me veprimin e vetëm noterial të kryer në qytetin e Gjirokastrës. Në dukje, lehtësisht dallohet se këto rrethana mbeten të pakundërshtueshme, po aq sa edhe deklarata noteriale e hartuar dhe e nënshkruar në qytetin e Gjirokastrës dhe, për pasojë, duket se çështja është delikate, për sa kohë kërkohet të evidentohet se kush mund të prijë në radhën e veprimeve për të vendosur kompetencën tokësore. Në përfundim, duke mos konstatuar parregullsi të natyrës procedurale, trupi gjykues çmon se rasti i trajtuar merr një vlerë të caktuar

³⁸ Ku parashikohet se: “...kompetenca përcaktohet në radhë të parë nga vendi ku është kryer veprimi ose ka ardhur pasoja”.

³⁹ Shihni vendimin datë 16.7.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, në dosjen hetimore që i përket procedimit penal nr***; procesverbalin datë 6.10.2016, të pyetjes së të pandehurit; procesverbalin datë 6.10.2016, për njohjen e mbrojtësit të të pandehurit me aktet; vendimin datë 30.11.2016, për potësimin e akuzës.

⁴⁰ Vendim nr. ***, datë 10.4.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

në interpretimin ligjor të bërë nga secili institucion që e ka hetuar dhe gjykuar, por që nuk lë vend për të ndikuar thelbësisht në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

C/2. Çështje të trajtuara bazuar në informacionin e DSIK-së

9. Komisioni administroi ⁴¹ dosjen penale që i përket procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasve A. I. dhe K. Z. .

9.1 Nga verifikimi i akteve të administruara rezultoi se këta shtetas janë akuzuar për kryerje të veprës penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1, paragrafi 2 i Kodit Penal. Trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të administruara, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë prokuror i kësaj çështjeje në asnjë fazë të hetimit të saj.

10. Komisioni administroi dosjen penale⁴² që i përket procedimit penal nr**** të vitit 2016, regjistruar për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit M. K. .

Nga aktet e administruara u konstatua si vijon:

10.i Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastër, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2016, i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër materialet procedurale për të arrestuarit në flagrancë, shtetasit M. K. dhe E. B. .

10.ii Në datën 12.5.2016 subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka ka urdhëruar “Regjistrimin e procedimit penal”, për veprën penale të “vjedhjes”, e kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal, ndaj personave nën hetim M.K. dhe E.B. .

10.iii Po në datën 12.5.2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë dy “kërkesa për vlerësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për të dy të dyshuarit, për secilin prej tyre, atë të “arrestit në burg”, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

10.iv Procedimi penal nr**** ka filluar në datën 12.5.2016, mbi bazën e akteve të referuara nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Gjirokastër, ndaj të pandehurve M.K., i proceduar nën masën e sigurimit personal “arrest në burg” (neni 238 i Kodit Penal), i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “vjedhjes”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal dhe shtetasi E.B. (i datëlindjes 28.6.1988), gjithashtu i proceduar nën masën e sigurimit personal “arrest në burg” (neni 238 i Kodit të Procedurës Penale), i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “vjedhjes”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal.

⁴¹ Me shkresën nr. ***prot., datë 24.2.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

⁴² Dërguar me shkresën nr. ***prot., datë 24.2.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

10.v Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 15.5.2016, ndaj personit nën hetim E.B., ka vlerësuar si të ligjshëm arrestin dhe ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

10.vi Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 15.5.2016, ndaj personit nën hetim M. K., ka vlerësuar si të ligjshëm arrestin dhe ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Pra gjykata, në të dyja rastet, ka vendosur sipas kërkesës së subjektit.

10.vii Në datën 24.5.2016 subjekti ka urdhëruar “Delegimin e veprimeve hetimore”, në bazë të neneve 33/3 dhe 304/2 të Kodit të Procedurës Penale, ku urdhëron oficerin e policisë gjyqësore M. Ç. që të kryejë disa veprime hetimore dhe detyra.

10.viii Në datën 31.5.2016 subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës”, me akuzën për kryerjen e veprës penale të “vjedhjes”, e mbetur në tentativë (nenet 134/2 dhe 22 të Kodit Penal).

10.ix Kërkesa për gjykimin e çështjes, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, është bërë nga subjekti i rivlerësimit Juljan Çafka në datën 2.6.2016.

10.x Në datën 2.6.2016 subjekti ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq.

10.xi Në aktin “Diskutim përfundimtar për çështjen penale nr. *** të vitit 2016”, të përgatitur nga subjekti i rivlerësimit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në mbështetje të nenit 378 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti për të dy të pandehurit veç e veç ka kërkuar “Deklarimin fajtor për veprën penale të ‘vjedhjes’, parashikuar nga nenet 134/2⁴³ dhe 22 të Kodit Penal dhe dënimin me 6 (gjashtë) muaj burgim; në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dënimin përfundimtar me 4 (katër) muaj burgim; në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, pezullimin për pjesën e pavuajtur dhe dënimin e të pandehurit me punë në interes publik, në afatin 60 orë”.

10.xii Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime⁴⁴, pasi dukej se masa e dënimit (në minimum), e kërkuar nga subjekti në diskutimin përfundimtar, nuk i përgjigjej parashikimit ligjor për veprën penale për të cilën, për të dy të pandehurit, kishte kërkuar të deklaroheshin fajtorë, si dhe të qartësonte lidhur me statusin aktual të kësaj çështjeje.

10.xiii Subjekti, në parashtrimet e tij, ndër të tjera është shprehur se: *“Në kërkimin e masës së dënimit, gjithmonë jam nisur nga parimet e përcaktuara në Kodin Penal dhe sidomos në nenin 47 të tij, në lidhje edhe me dispozitën specifike. Shtetasit M.K. dhe E. B. janë akuzuar për veprën penale të “vjedhjes”, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 134/2 e 22 të Kodit Penal. Për këtë vepër penale parashikohet dënimi në këtë nen nga 6 muaj deri në 5 vjet burgim. Nisur nga fakti që vepra penale ngeli në tentativë, nga pasojat e ardhura, nga fakti i ngeljes në tentativë të veprës, masha e personave, me të drejtë është aplikuar dënimi në minimum për të dy këta persona.*

⁴³ Në nenin 134/2 është parashikuar shprehimisht: “...Vjedhja e pasurisë [...] Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet”.

⁴⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

*Ka qëndrime të konsoliduara në praktikën tonë gjyqësore që theksojnë se që dënimi të ketë efekt rehabilitues, ai nuk duhet të përfaqësojë hakmarrjen e aparatit shtetëror ndaj personit, por duhet të perceptohet si i drejtë nga autori i veprës, çka bën që pesha e fajit të rëndojë sa dhe si duhet në koshiencën e tij. Ky qëndrim nuk përfaqëson asgjë më shumë veçse teorinë retributive të fajta dhe është një përfaqësim në drejtimet e ideve të Hegel⁴⁵. Pra, dënimi duhet të jetë brenda kufijve të fajit dhe në rastin konkret ka qenë i tillë”. Në lidhje me statusin ligjor të kësaj çështjeje, subjekti ka depozituar⁴⁶ vendimin nr. ***, datë 24.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.*

10.xiv Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, çmon se vlerësimi i çështjes nga subjekti në drejtim të disa rrethanave cilësuese qëndron. Sipas dokumentacionit të administruar rezultoi se vepra penale kishte mbetur në tentativë, si rezultat i të cilës nuk kishin ardhur pasoja. Neni 23 i Kodit Penal përmend si rregull dënimin më të butë të veprës së mbetur në tentativë, por që sigurisht duke u paraprirë ky vlerësim nga shkalla e afërsisë së pasojës, që në fakt në këtë rast kjo e fundit është provuar se nuk ka ardhur. Nga trajtimi i çështjes në këtë hetim administrativ, trupi gjykues vërejtë se subjekti ka hetuar dhe mbledhur të dhënat e nevojshme për të provuar kryerjen e veprës penale, si dhe ka vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese në dënimin e kërkuar për të akuzuarit. Po ashtu, në interpretim të nenit 134, ku parashikohen masat e dënimit për veprën penale të “vjedhjes”, parashikimi i bërë në nenin 134/2 dukshëm lë të kuptohet se vepra penale për të cilën akuzohen të pandehurit përfshin në ombrellën e penaltetit edhe bashkëpunimin. Kjo do të thotë se minimumi dhe maksimumi i dënimit për veprën penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal vlerësohet së bashku me bashkëpunimin e provuar në kryerjen e saj, që do të thotë kërkimi i subjektit të rivlerësimit përpara organit gjyqësor ka përfshirë dhe jo përjashtuar faktin se vepra është kryer në bashkëpunim, por gjithnjë duke e parë atë/bashkëpunimin jo si rrethanë rënduese, por thjesht dhe vetëm si rrethanë cilësuese. Në vlerësim të të gjithë çështjes është edhe fakti se kërkimi i subjektit në gjykatë është vlerësuar nga kjo e fundit në të njëjtin kontekst dhe masë dënimi, duke marrë vendimi formë të prerë, pa u ankimuar.

11. Komisioni administroi dosjen penale⁴⁷, që i përket procedimit penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit K. Sh. .

11.1 Nga aktet rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të këtij shtetasi për veprën penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal.

Rrethanat e çështjes

11.2 Sipas të dhënave të administruara rezultoi se shtetasi K. Sh., në cilësinë e drejtuesit të mjetit të tij, është diktuar nga forcat e rendit që patrullonin, pasi në automjet kishte marrë për të transportuar disa shtetas të huaj, të cilët kishin hyrë në territorin shqiptar nga kufiri i shtetit grek

⁴⁵ Rregulli është teza, vepra penale antiteza dhe dënimi sinteza, që vendos përsëri një ekuilibër të ri shoqëror.

⁴⁶ në seancë dëgjimore

⁴⁷ Nga shkresa përcjellëse e kësaj dosjeje, me nr***prot., datë 8.7.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, konfirmohet se për shtetasin H. M. procedimi i regjistruar me nr. ***është ndjekur dhe pushuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi.

dhe në deklarimet e tyre përpara OPGJ-së kishin deklaruar se do të vijonin të shkonin në Mal të Zi. Teksa ishte ndjekur dhe ndaluar nga forcat e rendit nuk kishte pranuar të ndalonte, por ishte larguar me shpejtësi. Në rrugë e sipër kishte zbritur klandestinët dhe më tej, i ndjekur përsëri prej forcave të rendit, kishte ndaluar, por në mjet tanimë nuk kishte pasur klandestinë. Ndërkohë, nga forcat e rendit ishte bërë e mundur kapja e tyre (e klandestinëve) gjatë rrugës. Të pyetur, dy prej këtyre të fundit kishin deklaruar se do të jepnin shumën prej 100 euro për këtë lëvizje me makinë, ndërsa i akuzuari deklaronte se nuk kishte pasur si qëllim transportimin e tyre, porse ishte gjendur në mënyrë rastësore për shkak se po shkonte në Delvinë për të marrë një banesë me qira e për të kaluar pushimet me familjen e tij.

Mbi kryerjen e veprimeve hetimore

11.3 Është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, shtetasi K. Sh., si dhe janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për veprën penale dy shtetas të huaj, të cilët kishin udhëtuar një pjesë të rrugës në automjetin e shtetasit Sh., si dhe dy punonjësit e policisë të cilët kishin ndjekur, kontrolluar e shoqëruar drejtuesin e mjetit.

11.4 Është vendosur kontrolli i automjetit të të dyshuarit Sh., është vlerësuar i ligjshëm sekuestrimi i sendeve të gjendura në automjet, është bërë vlerësimi i arrestimit në flagrancë, si dhe caktimi i masës së sigurimit “detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”.

11.5 Në datën 9.9.2013 OPGJ-ja F. V., në relacionin e tij, ka sugjeruar kalimin për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Sh., për kryerjen e veprës penale “dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal, duke renditur deklarimet kontradiktore midis: (i) të dyshuarit, i cili deklaronte se ishte nisur për të gjetur banesë me qira për familjen e tij dhe se përpara i kishin ngritur dorën disa pasagjerë, të cilët i ishin dukur si turistë dhe që kishin zbritur rrugës nga automjeti i tij, ndërsa është shkëmbyer me mjetin e policisë, por nuk ka vënë re ndonjë shenjë; dhe (ii) shtetasve të huaj të cilët, pasi ishin pyetur, kishin deklaruar se automjeti u ndalua por shoferi nuk pranoi të ndalonte, ndërsa u largua me shpejtësi, pasi i kishte thënë të zbrisnin se po i ndiqte policia dhe se paratë do t’ia jepnin kur të mbërrinin në Shkodër, për të kaluar më tej në Malin e Zi.

11.6 Në datën 16.9.2013 subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Pushimin e hetimeve”, duke argumentuar edhe lidhur me mospërputhjet në deklarime të dy të huajve, për të cilët arsyeton se njëri prej tyre ka përmendur se do të paguante shumën 100 euro për udhëtimin, ndërsa tjetri nuk e ka përmendur një fakt të tillë, duke pasqyruar në vendimmarrje se ky fakt do të çmohej në drejtim të besueshmërisë së tyre apo edhe faktin tjetër se janë pyetur në gjuhën greke dhe jo në gjuhën e tyre amtare, që edhe në këtë rast do të merret parasysh (është shprehur në vendim subjekti) fakti i njohurive të tyre në këtë gjuhë dhe mosartikulimi në mënyrën e duhur, se i dyshuari nuk ka bërë bisedë paraprake me asnjë nga klandestinët para se ata të takoheshin dhe të binin në marrëveshje për transportin e tyre, etj.

11.7 Sipas shkurtimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 31.7.2013 (provë e administruar në dosje), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është vendosur masa e sigurimit “detyrim paraqitje në

Policinë Gjyqësore”. Ndërsa, sipas procesverbalit⁴⁸, datë 31.7.2013, “për ekzekutimin e urdhrin të prokurorit”, vërehet se me vendimin e lartpërmendur është vendosur ndryshimi i masës së sigurimit nga “arrest në burg” në “detyrim paraqitje”.

11.8 Për sa më sipër, subjektit iu kërkua të japë shpjegime, pasi: (i) dukej se kishte vepruar në kundërshtim me nenin 73/3 të ligjit nr. 96/2016, duke mos pyetur shtetasit e huaj në gjuhën e tyre amtare⁴⁹; si dhe (ii) dukej se në vendimmarrjen e pushimit të çështjes kishte vepruar në kundërshtim me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të shpjegojë në raport me konkluzionet e OPGJ-së, si dhe të qartësojë nëse kishte qenë prokurori që kishte përfaqësuar organin e akuzës në kërkimin e secilës masë të sigurimit personal, dhe në vijim të shpjegojë arsyet mbi të cilat kishte konkluduar në ndryshimin e masës së sigurimit personal. Subjektit iu kërkua të depozitonte dokumentacion mbështetës, si dhe të qartësojë statusin aktual të kësaj çështjeje pas vendimit të pushimit.

11.9 Subjekti, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka sqaruar se: “[...] Së pari, vlen të theksohet se thelbi i vendimmarrjes sime, pushimi i procedimit penal nr. *** i vitit 2013, ka të bëjë me faktin që emigrantët e huaj deklaruan që nuk kanë bërë bisedë paraprake me drejtuesin e mjetit dhe as e kanë njohur atë para se ta takonin. Gjithashtu, nga ana e tyre u tha që kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa u ndihmuar nga ndonjë person, por vetëm nëpërmjet hartave. Në këto kushte, nisur edhe nga të dhënat e tjera, pretendimi i ndihmës për hyrje të emigrantëve në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk kishte asnjë bazë. Analiza u fokusua tek transporti i brendshëm dhe çfarë përfaqësonte ky transport, nisur nga provat e marra dhe fakti i rezultuar. Në analizën e bërë nga ana ime në vendim është evidentuar fakti se jo çfarëdo transporti i emigrantëve të paligjshëm do të përbënte elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 298 të Kodit Penal. Kjo sepse shumë veprime nuk dallojnë nga veprime të jetës së përditshme, por është qëllimi final ai që i diferencon (merret shembulli i ndihmës për qëllime humane, si ushqyerja, strehimi, etj.⁵⁰). Në këtë kontekst interpretimi, provueshmëria e rastit ndjek të gjithë linjën klasike të saj, si ekzistenca e faktit dhe provueshmëria e fajësisë. Ekzistenca e faktit në rastin konkret nuk mund të vërtetohet në kushtet vetëm të dëshmive, pa u vërtetuar nga prova reale, si kapja afër kufirit shtetëror, komunikime telefonike, etj. Në rastin konkret, njëri nga dëshmitarët deklaroi se ‘kemi bërë pazar me shoferin nga 100 euro deri në Shkodër’. Ky dëshmitar ishte nga Pakistani. Në vendim kam evidentuar diferencat në deklarime mes dy dëshmitarëve të huaj, por kjo është bërë me qëllim të vlerësimit të besueshmërisë së tyre dhe fakti i mospyetjes në gjuhën amtare është evidentuar si një element dytësor në përcaktimin e besueshmërisë. Megjithatë, në faktet e vëna në themel të vendimit, është pranuar fakti i transportimit deri në qytetin e Shkodrës i emigrantëve, siç dëshmitari Pakistani ka deklaruar. Mbi këtë bazë është bërë analiza ligjore e faktit, duke marrë parasysh që të dy dëshmitarët deklaruan se takimi me drejtuesin që rastësor, se nuk kishin bërë

⁴⁸ Numërtuar f. 35 në fashikull.

⁴⁹ Kodit i Procedurës Penale, neni 98/, Gjuha e akteve (ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017): “1. [...] 2. Personi që nuk flet gjuhën shqipe pyetet në gjuhën amtare ose në një gjuhë tjetër që kupton, të zgjedhur prej tij. Procesverbali mbahet në gjuhën shqipe”. Shkelja e këtyre rregullave sjell pavlefshmërinë e aktit.

⁵⁰ E kundërta çon në argumentin *ad absurdum*.

biseda paraprake, transporti i destinuar deri në qytetin e Shkodrës u konsiderua me të drejtë nga ana ime si transport i brendshëm dhe jo si element i anës objektive të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal. Lidhur me dy dëshmitarët e huaj: (a) ka qenë e pamundur të gjendet përkthyes për gjuhën amtare të tyre në atë kohë; (b) deklaratimet e tyre, megjithëse jo fort të artikuluar, kanë shprehur faktet kryesore; (c) standardi i pyetjes së dëshmitarëve në gjuhën që kuptojnë është në përputhje me përcaktimet e KEDNJ-së⁵¹ dhe u konfirmua edhe nga ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në vitin 2017; (d) në asnjë rast nuk dëshmohet dhe nuk u vërtetua se kalimi i kufirit është bërë me ndihmën e shtetasit K. Sh. . Pra, siç shihet, vendimmarrja ime ka qenë e drejtë, e bazuar në faktet e rezultuara dhe në provat e marra.

Së dyti, Komisioni pretendon se në vendimmarrjen e pushimit unë kam vepruar në kundërshtim me nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë nen, në kohën kur është marrë vendimi i pushimit, parashikohej se: 'Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod'. Gjithashtu, në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, në të dy variantet para dhe pas ndryshimeve janë përcaktuar rastet e vendimmarrjes së prokurorit, ku një nga mënyrat e vendimmarrjes ka qenë në atë kohë pushimi i akuzës ose i çështjes penale, kur nuk provohet kryerja e veprës penale dhe rastet e tjera të pushimit që listohen në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale. Sa më sipër, veprimi im nuk është në kundërshtim me nenin 24/1 të Kodit Penal. Referuar ligjit nr. 84/2016, 'Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', në nenin 43, paragrafi 1, theksohet se: 'Procedura e rivlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm'. Ligji nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', parashikon disa nga parimet, të drejtat e detyrat e magjistratit në ushtrimin e detyrës. Në nenin 3 të këtij ligji, parashikohet në paragrafin e parë se: 'Magjistrati ushtron funksionet e tij në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin'. Në paragrafin e katërt, përcaktohet se: 'Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim'. Po përmend edhe dy dokumente të rëndësishme ndërkombëtare që shprehin se në trajtimin e çështjeve gjyqësore autoriteti i vetëm vendimmarrës është gjykata (nënkupton para ndryshimeve prokuroria), e cila vlerëson ligjshmërinë e provave, por edhe fuqinë provuese të tyre. Në datën 17 nëntor 2010, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë miratoi Magna Carta e Gjyqtarëve, e cila përmban parimet themelore të funksionimit të një gjyqësori të pavarur në një shoqëri demokratike. Pikat 2, 3 dhe 4 të këtij akti qartësojnë pavarësinë jo vetëm thjesht si nocion normativ, por edhe parashikojnë garancitë e tjera që kjo pavarësi të jetë efektive dhe jo teorike. Po kështu, përmendim edhe Deklaratën Universale mbi Pavarësinë e Gjykatësve (1983) dhe Kartën Europiane për Statutin e Gjyqtarëve (Strasburg 1998). I përmend këto akte për të konkluduar se vendimmarrja ime në çështjen konkrete është produkt i një analize të pavarur, duke

⁵¹ Neni 6 i KEDNJ-së.

njohur mirë peshën dhe rëndësinë e çdo prove dhe jo objekt i ndikimeve të jashtme të çfarëdo natyre, qoftë edhe i diskutimit të tanishëm⁵².

Së treti, sipas Komisionit, shpjegimet e mia duhet të jepen edhe në raport me qëndrimin e oficerit të policisë gjyqësore në konkluzionet e tij. Rezulton se oficer i policisë gjyqësore ka qenë z. F. V., i cili ka përpiluar në përfundim të hetimeve relacionin e datës 9.9.2013. Shpjegimet e mia lidhur me zgjidhjen e çështjes i kam dhënë më sipër dhe në lidhje me qëndrimin e oficerit të policisë gjyqësore duket se ndajmë mendime të ndryshme, derisa ai ka sugjeruar ndryshe nga sa unë kam disponuar. Mendoj se oficeri i policisë gjyqësore nuk ka bërë një analizë të plotë e të saktë të provave dhe as ka bërë cilësimin e duhur ligjor të fakteve. Sugjerimi i oficerit të policisë gjyqësore nuk është detyrues për prokurorin.

*Së katërti, nga aktet e fashikullit të procedimit penal nr. *** të vitit 2013, më rezulton se në datën 30.7.2013 unë kam përpiluar kërkesën për vlerësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit, drejtuar gjykatës. Sipas kërkesës, unë kam kërkuar masën e sigurimit personal ‘detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore’, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale për shtetasin K. Sh. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. ***, datë 31.7.2013, ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe ka caktuar masën e sigurimit personal ‘detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore’ për këtë person. Mbi bazën e këtij vendimi, në datën 31.7.2013 kam nxjerrë urdhrin e ekzekutimit të vendimit të gjykatës, duke urdhëruar oficerin e policisë gjyqësore F.V. për lirimin e të arrestuarit. Oficeri i policisë gjyqësore F.V., në zbatim të urdhrin, ka përpiluar procesverbalin e datës 31.7.2013, ku është shprehur se masa është ndryshuar nga ‘arrest në burg’, në ‘detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore’. Duket qartë se është një shprehje e gabuar e oficerit të policisë gjyqësore, pasi nga tërësia e akteve të kësaj çështjeje penale rezulton se personi ka qenë i arrestuar, se është kërkuar masa e sigurimit e parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale dhe se është pranuar nga gjykata. Edhe nga pikëpamja ligjore, por edhe logjike, gjykata nuk mund të caktonte masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar prej meje. Po kështu, procedimi penal ka filluar në datën 29.7.2013, dhe logjikisht të gjitha aktet lidhen me masën e kërkuar, të caktuar dhe më pas të ekzekutuar. Ndoshta oficeri i policisë gjyqësore ka menduar se fakti që personi ishte i arrestuar, do të konsiderohej si i mbajtur nën masë sigurimi ‘arrest në burg’. Nga aktet e procedimit penal, kjo çështje penale rezulton të jetë pushuar me vendimin e datës 16.9.2013”.*

11.10 Trupi gjykues, në referencë të shpjegimeve dhe analizës ligjore të prezantuar nga subjekti, krijon bindjen se arsyetimet e këtij të fundit për të qartësuar faktin se i akuzuari nuk ka pasur rol dhe ndikim në kalimin e paligjshëm të kufirit nga të tretë ndaj të tretëve dhe, për pasojë, në kryerjen e veprës penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal, qëndrojnë. Nën këtë logjikë prezantohet dhe arsyetohet vlerësimi i rastit. Më konkretisht, vërehet se subjekti ka analizuar disa elemente të veprës penale në kompleks, duke konsideruar prova konkrete, por edhe rrethanore për të konkluduar në pushimin e çështjes, vendim i mbetur

⁵² Gjithashtu edhe në nenin 6 të KEDNJ sanksionohet e drejta për t’u gjykuar nga një gjykata e pavarur e caktuar me ligj dhe jurisprudenca e kësaj gjykata e ka elaboruar qartë këtë term.

me të njëjtin status, sikurse është shprehur subjekti në seancën dëgjimore. Në tërësi, subjekti ka hetuar, ka grumbulluar të dhëna, të cilat kryesisht i ka fokusuar në provueshmërinë e faktit se: (i) klandestinët nuk janë marrë në pikën kufitare, pra duke u përjashtuar në këtë mënyrë implikimi i të akuzuarit për ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, por janë marrë gjatë rrugës teksa i akuzuari drejtonte mjetin e tij me një qëllim të caktuar të tij familjar dhe që nuk kishte lidhje me situatën e krijuar; (ii) shtetasit e huaj kanë mbajtur qëndrime të ndryshme lidhur me pagesën e transportit; si dhe (iii) nuk është anashkaluar prej subjektit marrja në pyetje e shtetasve të huaj, por për shkak të mungesës së përkthyesve në gjuhën e tyre amtare, por edhe të pranisë së tyre për të komunikuar në një gjuhë tjetër ku kishin pasur vendqëndrimin e tyre apo edhe të një vakumi ligjor (sipas legjisllacionit të kohës), janë pyetur në gjuhën e radhës/që kuptojnë. Kjo e drejtë për t'i pyetur shtetasit e huaj i ka buruar reciprokisht subjektit nga legjisllacioni i kohës, por edhe nga neni 6/3/a i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe shtetasve të huaj nga prania e tyre për të deklaruar në një tjetër gjuhë, veç amtares. Duket se këto hetime, gërshetuar edhe: (i) me bindjen e krijuar nga subjekti si një e drejtë e tij e lejuar; por edhe me (ii) masën e sigurimit personal, “detyrim paraqitje”, duke i dhënë ndëshkimin e parë të akuzuarit, kërkuar dhe vendosur paraprakisht ndaj këtij të fundit, kanë ndikuar në vendimmarrjen e subjektit. Në këto kushte e rrethana, trupi gjykoës nuk dikton sjellje apo veprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të tij.

Në lidhje me 19 denoncimet⁵³ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si vijon:

Pas shqyrtimit në tërësi të denoncimeve, për 5 prej tyre të paraqitura, përkatësisht nga shtetasit P.Ç. në mënyrë të përsëritur, L. P. dhe E.L. nuk u konkluduan fakte apo rrethana të cilat mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Në vijim, Komisioni u përqendrua në pretendimet e denoncuesve të tjerë, renditur në vijim, ku edhe në këtë rast 3 prej tyre kanë paraqitur denoncime të përsëritura, por që Komisioni i ka kërkuar në tërësi shpjegime, qartësime apo edhe prova mbështetëse.

1. Denoncim⁵⁴ i shtetasit B.L.

1.1 Denoncuesi, në ankimin e tij, nuk ka përshkruar shkelje konkrete në adresë të subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi ka depozituar disa vendime gjyqësore, ku herë shfaqet në cilësinë e palës paditëse dhe herë në cilësinë e palës së paditur. Çështja, objekt gjykimi, rezulton të jetë konflikt pronësor, i cili ka ndjekur edhe procedura përmbartimore. Nga njëra anë, shtetasi L. pretendon *për lirim dhe dorëzim të objektit dhe sipërfaqes së truallit prej 150 m²*, dhe nga ana tjetër për këtë pasuri pretendon edhe një tjetër shtetas, të cilët reciprokisht i janë drejtuar gjyqësorit me padi dhe kundërpadi.

⁵³ Ku denoncuesi P. Ç. ka paraqitur 3 denoncime me të njëjtin objekt ankimi, denoncuesi V.Ç. ka paraqitur 4 denoncime me të njëjtin objekt ankimi, denoncuesi D. H. ka paraqitur 2 denoncime me të njëjtin objekt ankimi, denoncuesja M.Sh. ka paraqitur 2 denoncime me të njëjtin objekt kërkimi dhe po ashtu edhe denoncuesi K. Zh. ka paraqitur 2 denoncime me të njëjtin objekt ankimi.

⁵⁴ Dononcim nr. *** prot., datë 24.11.2017.

1.2 Nga dokumentacioni i administruar (depozituar nga denoncuesi) rezultoi një korrespondencë e mbajtur nga denoncuesi në vitin 2009 me organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku vërehet se shtetasi B. L. sqaron se ka paraqitur në vitin 2007 një kallëzim në këtë prokurori *për shkatërrim prone dhe përdorim me keqdashje të thirrjeve telefonike*, e cila më tej ka regjistruar procedimin penal nr. *** dhe pas kryerjes së disa veprimeve hetimore (gjithnjë sipas denoncuesit) ka vendosur pushimin e procedimit. Më tej, ai informon në korrespondencën e tij se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur prishjen e këtij vendimi në datën 17.2.2009 dhe dërgimin e çështjes për hetime të mëtejshme. Në këto kushte, ka kërkuar të informohet, pasi nuk ka pasur asnjë njoftim nga organi i prokurorisë lidhur me kthimin dhe vijimin e hetimeve të mëtejshme të çështjes. Në përgjigje të kërimit të denoncuesit rezultoi një shkresë e subjektit të rivlerësimit, ku i konfirmohet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin datë 3.7.2009, ka vendosur pushimin e hetimeve lidhur me kallëzimin e bërë.

1.3 Për sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë shpjegime: (i) duke u përqendruar tek pretendimet e denoncuesit në raport me mosdijeninë e pretenduar nga denoncuesi mbi vendimmarrjen e radhës; (ii) të qartësojë statusin e tij lidhur me hetimin e çështjes së regjistruar në vitin 2007, kthyer nga gjykata në vitin 2009 për hetime të mëtejshme; (iii) të qartësojë statusin e tij lidhur me hetimet e kryera pas kthimit të çështjes nga gjykata deri në vendimmarrjen e radhës në datën 3.7.2009; si dhe (iv) të depozitojë dokumentacion mbështetës.

1.4 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar si vijon:

a. Lidhur me mosdijeninë e pretenduar të denoncuesit B. L. mbi vendimmarrjen e radhës, pavarësisht se referuar nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, në paragrafin e tretë të tij, ky procedim penal del jashtë periudhës së vlerësimit profesional dhe nuk janë kushtet për shtrirjen e vlerësimit edhe jashtë kësaj periudhe, siç përcakton paragrafi i katërt i këtij neni, subjekti e çmon të arsyeshme të japë shpjegime për çështjen penale në fjalë. Ai shpjegon se *nuk jemi përpara kushteve të nenit 41 paragrafi 4 të këtij ligji, sepse lidhur me etikën dhe aftësitë profesionale nuk ka dhe nuk ka pasur probleme. Shtetasi B. L. ka pretenduar se nuk është njoftuar mbi vendimmarrjen e radhës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Rezulton se ky shtetas ka kallëzuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë një kallëzim penal në datën 11.12.2007, lidhur me shkatërrimin e pronës së tij, për të cilin është regjistruar procedimi penal nr*** i vitit 2007. Ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 7.3.2008. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim në gjykatë kallëzuesi B. L. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2009, ka vendosur “Prishjen e vendimit të pushimit të hetimeve dhe vazhdimin e hetimeve për procedimin penal nr. *** të vitit 2007”. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.2.2009 dhe është administruar nga prokuroria në datën 25.2.2009. Pas kthimit të akteve janë kryer veprimet e tjera hetimore dhe është vendosur pushimi i hetimeve. Në pikën e dytë të vendimit është përmendur fakti që vendimi duhet t’i njoftohet kallëzuesit B. L. . Po kështu, i është bërë e ditur me shkresë se është marrë vendimi i pushimit të hetimeve për këtë procedim penal dhe ftohej të paraqitej për ta tërhequr në sekretarinë e prokurorisë. Rezulton se shtetasi B. L. e ka tërhequr kopjen e vendimit të pushimit të hetimeve, referuar shënimit që ka vendosur në origjinalin e aktit.*

Në vendimin e pushimit të hetimeve, që është pjesë e fashikullit të procedimit penal, gjendet nënshkrimi i shtetasit B.L., që dëshmon se ai ka marrë njoftim efektivisht për këtë vendim. Po kështu, në pjesën dispozitive të vendimit të pushimit, subjekti shpjegon se *ka përmendur shprehimisht se vendimi duhet t'i njoftohet shtetasit B. L.. Përmendja e emrit të kallëzuesit si person që duhet të njihej me vendimin në dispozitivin e vendimit është bërë me qëllim realizimin e njoftimit të këtij personi dhe tregon qartë predispozicionin e subjektit për realizimin e këtij qëllimi. Pasi u njoh me faktin që personi nuk kishte marrë dijeni për vendimin, ka ndër marrë hapa dhe është angazhuar për realizimin e njoftimit, i cili është realizuar pa zvarritje.*

b. Lidhur me statusin e tij në këtë çështje, subjekti ka sqaruar se është emëruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me dekret të Presidentit të Republikës, në datën 6.11.2008. Procedimi penal nr. *** i vitit 2007 nuk është hetuar fillimisht prej tij, por është hetuar nga prokurorja R. Gj., e cila ka vendosur në përfundim të hetimeve pushimin e çështjes, me vendimin e datës 7.3.2008. Mbi ankimin e shtetasit B. L., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit të çështjes, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve me vendimin nr. ***, datë 2.2.2009. Subjekti ka shpjeguar se *në këtë gjykim ka marrë pjesë si përfaqësues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Pasi çështja është kthyer për hetime më 17.2.2009, çështja i është caktuar atij dhe pasi janë kryer veprimet hetimore, ka marrë vendimin e pushimit të saj.* Subjekti ka depozituar: vendimin e prokurores R. Gj. për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2007; vendimin nr. ***, datë 2.2.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; si dhe vendimin datë 10.7.2009, të prokurorit Julian Çafka për pushimin e hetimeve.

1.5 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit lidhur me pretendimet e denoncuesit, si dhe dokumentacionit të administruar, më konkretisht vendimet e organit të akuzës, si dhe vendimin gjyqësor për kthimin e çështjes për hetime të tjera, vëren se subjekti ka hetuar dhe përfunduar këtë çështje pas kthimit të saj nga gjykata. Trupi gjykues në këtë çështje konstaton se denoncuesi ka marrë dijeni mbi vendimin e subjektit të rivlerësimit për pushimin e çështjes, fakt ky i pasqyruar pikërisht në këtë akt, por në një periudhë relativisht të gjatë krahasuar me datën e vendimit. Parë në një kontekst më të gjerë, ajo që mbetet evidente është fakti se pretendimet i referohen vitit 2009, që do të thotë se me kalimin e kohës ai do të duhej të jepte më shumë detaje dhe prova të cilat mund të ndikonin në vlerësimin profesional të subjektit. Ndërsa denoncuesi informon mbi një çështje për të cilën ka nënshkruar marrjen dijeni mbi zgjidhjen e saj, duke mos rezultuar kështu, sikurse ai pretendon. Nga ana tjetër, duket sikur denoncuesi është pajtuar me vendimmarrjen e organit të akuzës, për sa kohë nuk rezultoi ndonjë ankim i pretenduar apo i paraqitur. Në kushte të tilla, për sa kohë subjekti ka saktësuar në dispozitivin e vendimit edhe njoftimin e tij kallëzuesit/denoncuesit (në rastin objekt hetimi administrativ), duket se janë kryer dhe zbatuar veprimet e duhura procedurale dhe, për pasojë, nuk diktohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncimet⁵⁵ e shtetasit V. Ç.

2.1 Denoncuesi ankohet për disa subjekte rivlerësimi dhe ndër të tjera ankohet për pushimin e padrejtë të çështjes penale nr. *** të vitit 2014, regjistruar për veprën penale të “vjedhjes“, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

2.2 Denoncuesi ka depozituar kërkesën e subjektit, datë 24.1.2020, për “Pushimin e procedimit penal”, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

2.3 Në referim të pretendimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi, Komisioni i ka kërkuar⁵⁶ subjektit shpjegimet përkatëse.

2.4 Në përgjigjen e tij⁵⁷, subjekti ka shpjeguar se çështja penale nr. *** e vitit 2014 është hetuar nga prokurori S.Ç., i cili ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal dhe më pas ka përpiluar vendimin për pezullimin e hetimeve.

2.5 Në vijim, subjekti ka sqaruar se referuar aktekspertimit vlerësues të datës 10.6.2014, rezultoi se vlera e sendit të vjedhur ka qenë në shumën 5.000 (pesë mijë) lekë, duke e cilësuar faktin sipas nenit 134/1 të Kodit Penal. Në vijim, prej tij është konstatuar se kishin kaluar afatet e parashikuara nga ligji për ushtrimin e ndjekjes penale dhe bazuar në nenin 66, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e hetimeve.

2.6 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 23.7.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes penale, vendim për të cilin ka pasur ankim nga viktima e veprës penale. Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka dërguar vendimin nr. ***, datë 23.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe fashikullin e procedimit penal nr. ***, kallëzimi nr***prot., datë 5.6.2014.

2.7 Nga analizimi i këtij dokumentacioni⁵⁸ rezultoi se vepra penale ka ndodhur në datën 3.6.2014.

2.8 Policia Gjyqësore ka kryer disa veprime hetimore procedurale⁵⁹, të cilat, me shkresën nr. ***prot., datë 4.6.2016, ia ka dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

2.9 Urdhri për regjistrimin e procedimit penal, datë 5.6.2014, është nënshkruar nga një subjekt tjetër rivlerësimi, i cili ka vendosur⁶⁰ kryerjen e një ekspertimi për vlerësimin e dëmit nga vjedhja e televizorit të markës “Shark”. Ekspertimi mban datën 10.6.2014 dhe përcakton si vlerë dëmi shumën 5.000 lekë.

⁵⁵ Denoncimet nr. *** prot.; datë 4.8.2020; nr. *** prot., datë 19.8.2019; nr***prot., datë 16.10.2019; dhe nr. *** prot., datë 24.2.2020.

⁵⁶ Me pyetësin nr. 3, datë 1.7.2021.

⁵⁷ Dërguar me *e-mail*-in e datës 7.7.2021.

⁵⁸ Vendim nr. ***, datë 23.7.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

⁵⁹ F. 4 e fashikullit të procedimit penal nr. ***.

⁶⁰ Vendim datë 10.6.2014.

2.10 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (konkretisht, subjekti tjetër i rivlerësimit) në datën 28.6.2014 ka vendosur pezullimin e procedimit penal për shkak të mosgjetyes së autorit/autorëve të ngjarjes.

2.11 Referuar vendimit nr. ***, datë 23.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me qëllim shqyrtimin e kushteve për parashkrim të ndjekjes penale, në datën 24.1.2020 ka vendosur rifillimin e hetimeve lidhur me procedimin penal nr. *** të vitit 2014 (veprim i ndërmarrë nga subjekti). Gjithashtu, në vendim citohet se kërkesa për pushim është depozituar në gjykatë në datën 2.3.2020.

2.12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 23.7.2020, në zbatim të nenit 66, germa “ç” e Kodit Penal dhe neneve 328/1, germa “f”, 329/a/1, 329/b, pika 3 dhe nenit 387 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. 318, datë regjistrimi 5.6.2014, regjistruar për veprën penale të “vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

2.13 Gjykata ka arsyetuar se vepra penale “vjedhje”, neni 134 i Kodit Penal, parashikon se: *“Vjedhja e pasurisë dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet [...]”*. Në këto kushte, gjykata arsyeton se në referim të nenit 66, germa “ç” e Kodit Penal, i cili parashikon se: *“Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur kanë kaluar: [...] ç) pesë vjet për krimet që parashikojnë dënim gjer në pesë vjet burgim ose gjobë, ndjekja penale është parashkruar pasi nga momenti i ndodhjes së ngjarjes, datë 3.6.2014, e deri në datën e shqyrtimit gjyqësor kanë kaluar mbi pesë vjet”*. Ky fakt, sipas saj përbën shkak për pushimin e ndjekjes penale, në kuptim të nenit 328/1, germa “d” e Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: *“[...] vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur: [...] d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhet të fillohet ose nuk duhet të vazhdojë”*.

2.14 Efektet e këtij vendimi pezullimi kanë filluar nga kjo datë dhe kanë përfunduar në datën 24.1.2020, kur subjekti ka rifilluar⁶¹ hetimet me qëllim shqyrtimin e kushteve për parashkrim të ndjekjes penale (referuar vendimit të gjykatës). Në datën 2.3.2020 subjekti i ka drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë kërkesën (që mban datën 24.1.2020) për pushimin e çështjes penale.

2.15 Në fashikull nuk rezultoi të jetë akti i caktimit të subjektit si prokuror për ndjekjen e kësaj çështjeje dhe veprimet e tjera procedurale të ndjekura prej tij (vendimi i rihapjes së hetimeve, kërkesa për pushimin e çështjes).

2.16 Komisioni i kërkoi subjektit të depozitonte aktet e përshkruara në pikën nr. 2.15 më sipër, në përgjigje të së cilës subjekti ka sqaruar se: *“Lidhur me caktimin e prokurorit për procedimin penal nr. *** të vitit 2014, pasi ky procedim ishte kthyer nga Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë për shkak se ish-in plotësuar afatet e parashkrimit, duke qenë se kjo çështje penale nuk hynte në*

⁶¹ Sipas akteve shoqëruese, bashkëlidhur denoncimit nga denoncuesi.

kategorinë e çështjeve të ardhura rishtaz dhe duke qenë se prokurori që e kishte ndjekur më parë atë nuk ushtronte funksionin në këtë kohë, iu nënshtrua shortit manual, ku u caktova unë për ta ndjekur atë”. Subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës: (i) vendimin datë 28.6.2014, të prokurorit për pezullimin e hetimeve; (ii) vendimin datë 24.1.2020, të prokurorit për rifillimin e hetimeve; (iii) kërkesën datë 24.1.2020, për pushimin e çështjes penale; (iv) vendimin nr. *** datë, 23.7.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; si dhe (v) vendimin nr. ***, datë 17.9.2020, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

2.17 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, vëren se çështja i është nënshtruar hetimeve fillimisht nga të tjerë subjekte dhe së fundmi nga subjekti i rivlerësimit. Konstatohet se veprimi i subjektit për rifillimin e hetimeve, si veprim i parë i tij lidhur me këtë çështje, është kryer në përputhje me parashikimet ligjore të institutit të parashkrimit, çka do të thotë se subjekti me të drejtë ka vënë në lëvizje çështjen, duke rinisur hetimin i cili ka qenë i pezulluar për shkak të mos gjetjes së autorit të veprës penale dhe në kushtet e tejkalimit të afateve për ndjekje penale nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si të pandehur, ka rezultuar në vendimmarrjen e pushimit të procedimit penal, vendim i cili është ligjësuar në shkallët më të larta të gjyqësorit si garant i tyre mbi ushtrimin e të drejtës ankimore nga denoncuesi. Në të tilla kushte, duket se nuk prezantohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim⁶² i shtetasit D.L.

3.1 Denoncuesi, në ankimin e tij, pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime për çështjen e tij. Subjekti ka depozituar dokumentacion, i cili kryesisht përfshin vendime gjyqësore, në të cilat konstatohet se kallëzimet e denoncuesit konsistojnë në faktin se ai është mashtruar në një marrëdhënie pasurore me një të tretë për blerje të një apartamenti, duke dhënë shuma të konsiderueshme parash. Kryesisht vendimet (është shprehur ai) janë pushuar ose mosfilluar nën arsyetimin se nga hetimet e kryera nuk ka elemente të veprës penale, të parashikuara nga neni 143 i Kodit Penal, pasi ndërmjet dy personave është krijuar një marrëdhënie juridiko-civile, të cilat pranohen me faktet e njohjes së detyrimit, ushtrimi i aktivitetit privat nga marrësi i shumës dhe konfirmimi i shumës nga ky i fundit.

3.2 Nga dokumentacioni i administruar vërehet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 30.11.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 10.2.2016, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve sipas detyrave të përcaktuara në arsyetimin e vendimit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 12.4.2019 ka vendosur mosfillimin e ankimit penal të bërë nga denoncuesi, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

⁶² Denoncim nr. *** prot., datë 19.8.2019.

3.3 Për sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të qartësojë pozitën e tij në vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 10.2.2016⁶³, të japë shpjegime duke u përqendruar tek pretendimet e denoncuesit, të detajojë në mënyrë kronologjike situatën e kallëzimeve të këtij denoncuesi, ecurinë e tyre, si dhe statusin aktual.

3.4 Subjekti ka qartësuar pozitën e tij në vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 10.2.2016, ku është shprehur se: *“Siç rezulton nga vendimi i sipërcituar, unë kam qenë prokurori që kam trajtuar dhe kam dalë me vendim për ankesën e bërë nga shtetasi D. L., të dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka përcjellë atë me shkresën nr. ***, datë 8.1.2016”.*

3.5 Subjekti ka përshkruar detaje të çështjes, duke sqaruar se *“Shtetasi D. L. dhe Q. H. kanë lidhur një marrëveshje, ku shtetasi D. L. do blinte nga Q. një garsoniere në Golem/Durrës dhe për këtë shtetasi D. L. i kishte dhënë paraprakisht Q. një pjesë të çmimit të shitjes. Më pas, kjo marrëveshje është zgjidhur, për shkak se Q. e kishte shitur garsonieren dhe i ka kthyer D. vetëm një pjesë të parave të dhëna më parë. D. pretendoi se ishte mashtruar nga Q., për shkak se ky i fundit nuk i kishte kthyer të gjithë shumën e parave.*

*Me vendimin e datës 10.2.2016, është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga ana ime, duke e konsideruar marrëdhënien mes këtyre dy personave si mardhënie juridiko-civile. Kundër këtij vendimi kam bërë ankim në gjykatë shtetasi D. L., i cili ka kërkuar prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr***, datë 30.11.2017, ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi, kam bërë ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila, me vendimin nr. ***, datë 10.1.2018, ka vendosur mospranimin e ankimit. Mbi bazën e vendimeve të sipërcituara është regjistruar procedimi penal dhe janë kryer një sërë veprimesh hetimore. Ndër të tjera, është bërë një ballafaqim mes shtetasve Q. H. dhe D.L., ku gjatë ballafaqimit shtetasi D.L. ka pranuar se i janë kthyer nga shtetasi Q. H. shuma prej 23.700 (njëzet e tre mijë e shtatëqind) euro dhe pohoi se do të shlyente edhe shumën e mbetur në vazhdim. Pas kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, me kërkesë i jam drejtuar gjykatës për pushimin e akuzës dhe të çështjes penale, pasi rrethanat e faktit nuk formojnë elementet e figurës së veprës penale të ‘mashtrimit’, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, por marrëdhënia ishte juridiko-civile. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr***, datë 10.1.2019, vendosi pushimin e akuzës ndaj shtetasit Q. H. dhe pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2018. Përveç këtij procedimi penal, kam trajtuar edhe kallëzimin penal nr. ***, datë 6.2.2018, të paraqitur nga shtetasi D. L. . Ky person ka bërë kallëzim në datën 2.2.2018, kundër shtetasit Q. H., duke pretenduar se shtetasi Q.H. e ka kërcënuar nëpërmjet telefonit. Duke konsideruar se rrethanat e faktit nuk formojnë elemente të figurës së veprave penale të parashikuara nga nenet 84 dhe 275 të Kodit Penal, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal. Nga tërësia e veprimeve të kryera, vetëm sa është konfirmuar fakti se ndodhemi para një mardhënieje juridiko-civile ku nuk janë ezauruar të gjitha pasojat e mospërmbushjes së detyrimeve. Vendimmarrja ime ka qenë*

⁶³ Pasi në vendimin e gjykatës subjekti ka cilësinë e përfaqësuesit të organit të akuzës, ndërsa mungonte vendimi i mosfillimit, objekt i këtij vendimi gjyqësor.

e drejtë dhe denoncimin e këtij personi, nëse është ky person që ka denoncuar, e konsideroj të padrejtë. Që të ekzistojë vepra penale kërkohet të respektohet parimi i koncidencës, që do të thotë që veprimi (actus reus) dhe mendimi kriminal (mens rea) të ekzistojnë në të njëjtën kohë. Përputhshmëria në kohë, në rastin konkret, do të ishte që në momentin që shtetasi Q. H. ka marrë shumën e parave dhe po në këtë moment do të kishte pasur për qëllim moskthimin e gjithë shumës apo një pjese. Në rastin konkret, nga provat e marra, nga fakti që ai ka likuiduar një pjesë të tyre, nga fakti që objekti i marrëveshjes ekzistonte vërtet dhe ishte në pronësi të tij dhe nga fakti që e pranonte detyrimin, së paku ngelet dyshimi i arsyeshëm se ai nuk e ka pasur mendimin kriminal në kohën e bërjes së marrëveshjes”.

3.6 Subjekti ka depozituar: (i) vendimin e mosfillimit të procedimit penal, datë 10.2.20016; (ii) vendimin nr. ***, datë 30.11.2017, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; (iii) kërkesën për pushimin e akuzës dhe të çështjes penale, nr. *** të vitit 2018; (iv) vendimin nr. ***, datë 10.1.2019, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; si dhe (v) vendimin e mosfillimit të procedimit penal, datë 13.2.2018, lidhur me kallëzimin penal nr. *** të vitit 2018.

3.7 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti, dokumentacionit të depozituar, si dhe panoramës së plotë pararendëse të çështjes, çmon se nuk ka tagrin të analizojë zgjidhjen e çështjes në themel, që në fakt ka të bëjë me argumentet e prezantuara nga subjekti se çështja në thelb kishte të bënte me një marrëdhënie juridiko-civile, për shkak të një konflikti pronësor me pasojë detyrim dhe pagim të një shume të caktuar. Por, nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se proceduralisht subjekti është gjendur përpara një vendimi të marrë prej tij, i cili është prishur dhe kthyer nga gjykata për hetime të tjera me detyra të mirëpërcaktuara për t’u realizuar. Në këtë kontekst, trupi gjykues vëren se vendimmarrja e radhës nga subjekti, për të cilin u kërkua dhe njëkohësisht u vendos nga gjykata pushimi i çështjes, është rezultat i kryerjes së hetimeve të mëtejshme nga subjekti, çka do të thotë se prishja e vendimit të mosfillimit ka qenë e duhura, me qëllim që subjekti të kryente një hetim të plotë dhe shterues. Megjithatë, duke parë zgjidhjen e kësaj çështjeje nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitetit, gërshetuar edhe me bindjen e brendshme të prezantuar nga subjekti, me të cilën ka ndërmarrë veprimet hetimore në kontekstin e vlerësimit si një çështje që zgjidhet civilisht apo edhe me detyrat e realizuara në vijim, të cilat kanë konkluduar në të njëjtën linjë edhe në organin e gjyqësorit, duket se nuk reflektohen shkaqe apo rrethana të cilat mund të ndikojnë thelbësisht në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3.8 Ndërsa, në lidhje me denoncimin⁶⁴ e shtetasit D. H. (i pasqyruar brenda denoncimit të shtetasit D. L., duke qenë se ka pasur një mbivendosje të denoncimeve në trajtimin e tyre për shkak se denoncuesit kanë të njëjtin emër), subjekti në parashtrimet e dhëna për denoncimin e shtetasit D.

⁶⁴ Denoncim nr. *** prot., datë 2.9.2019.

L. (trajtuar më sipër) ka qartësuar se me të dhënat D. H.⁶⁵ nga ana e tij nuk është gjetur asnjë akt i përpiluar.

4. Denoncim⁶⁶ i shtetasit A.S.

4.1 Denoncuesi, ndër të tjera në ankimin e tij, ka pretenduar se subjekti nuk ka marrë parasysh një sërë faktesh të dokumentuara lidhur me çështjen objekt pronësie, objekt hetimi. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se prokurori nuk ka zbatuar detyrat e lëna lidhur me çështjen, objekt hetimi, nga ana e gjykatave të cilat e kanë shqyrtuar. Sipas denoncimit bëhet fjalë për procedimin penal nr. *** të vitit 2011, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për të cilën prokurori Juljan Çafka, në datën 7.9.2015, ka vendosur pushimin e tij.

4.2 Subjektit i është kërkuar⁶⁷ të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit, duke vërtetuar në çdo rast pretendimet me dokumente nga dosja penale, i cili në përgjigjen e tij ka sqaruar se: *“Shtetasi A.S. ka bërë kallëzim penal, duke kërkuar ndjekje penale ndaj shtetasve Sh. H. dhe V. H., pasi sipas tij ata kanë falsifikuar aktin e marrjes së tokës në pronësi. Konkretisht, ai pretendonte se ky akt i marrjes së tokës në pronësi ishte falsifikuar tek rreshti që bën fjalë për një parcelë me emrin ‘***’, me sip. 9.900 m². Në këtë parcelë ndodhej një sipërfaqe trualli prej 300 m², që i është dhënë shtetasit A. S. nga organet vendore dhe në të cilin ai kishte ndërtuar një karburant. Shtetasi A. S. ka bërë kallëzim penal në datën 3.8.2011. Në datën 4.8.2011 është regjistruar procedimi penal dhe çështja është hetuar nga prokurori S. Ç. . Me vendimin e datës 2.12.2011 është vendosur pushimi i hetimeve për këtë procedim penal nga ky prokuror. Ky vendim është shfuqizuar nga drejtuesi i prokurorisë A. P., me vendimin e datës 13.12.2011. Pasi janë kryer hetime të drejtuara nga prokurori S. Ç., me vendimin e datës 17.1.2013 është vendosur pushimi i hetimeve për këtë procedim penal. Kundër këtij vendimi është ankuar shtetasi A. S. dhe gjykata, me vendimin nr. ***, datë 2.4.2013, vendosi prishjen e vendimit të pushimit të çështjes, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Më pas, në muajin janar të vitit 2014 jam caktuar unë si prokuror për hetimin e kësaj çështjeje penale. Me urdhrin e datës 27.1.2014 i janë deleguar veprimet hetimore oficerit të policisë pjyqësore. Është kryer ekspertim teknik jo vetëm i AMTP-së nr. ***, në emër të Sh. H., por edhe i listës së familjeve që morën tokë në pronësi në fshatin T. . Gjithashtu janë kryer edhe veprime të tjera hetimore, ku vlen të përmendet edhe praktika e verifikimit të bërë nga prefekti i qarkut Gjirokastrë, i cili ka shkëmbyer edhe korrespondencë për verifikim me komunën Q. dhe ka gjetur të rregullt aktin e marrjes së tokës në pronësi. Janë shqyrtuar edhe kërkesa të paraqitura nga kallëzuesi A. S. . Duke qenë se akti i marrjes së tokës në pronësi përputhej në të dhënat me listën e familjeve që morën tokë në pronësi, ku rekuizita e parcelës në listë ishte pasqyruar pa ndryshime, dilte e qartë se dokumenti nuk paraqiste falsifikim, dhe me vendimin e datës 7.9.2015 është vendosur pushimi i çështjes penale. Kundër këtij vendimi është ankuar shtetasi A. S. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 4.3.2016,*

⁶⁵ Ky denoncim ka pasur si objekt ankimin ndaj subjektit lidhur me një vendim mosfillimi (datë 10.6.2015), i cili sipas akteve rezultoi i kundërshtuar nga denoncuesi dhe më tej i gjykuar dhe rrëzuar nga gjykata me vendimin nr*** , datë 18.4.2019. Denoncuesi në këtë rast nuk ka ushtruar të drejtën ankimore.

⁶⁶ Denoncim nr. ***prot., datë 8.2.2018.

⁶⁷ Me pyetësorin nr. 3, datë 1.7.2021.

*vendosi prishjen e vendimit të pushimit të hetimeve, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Pas kthimit të çështjes për vazhdimin e hetimeve është kryer një ekspertim topografik dhe ekspertim teknik AMTP, si dhe veprime të tjera hetimore. Me vendimin e datës 19.7.2017 është vendosur pushimi i çështjes penale nr. *** i vitit 2011. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga shtetasi A. S. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 31.10.2017, vendosi rrëzimin e kërkesës së shtetasit A. S. . Lidhur me ankesën e shtetasit A. S., pretendimet e tij nuk qëndrojnë. Të gjitha veprimet hetimore të kryera, të gjitha ekspertimet, si dhe verifikimet e tjera kanë shkuar në kah të rrëzimit të pretendimeve të shtetasit A.S. ”.*

4.3 Subjekti ka depozituar vendimin nr. ***, datë 31.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

4.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar, vëren se çështja objekt hetimi, e vënë në lëvizje nga denoncuesi (me cilësinë e kallëzuesit), me kundërshtimin se për kallëzimin e bërë nuk ishin kryer hetime të plota dhe se nuk ishin zbatuar detyrat e lëna nga gjykata, fillimisht është hetuar dhe pushuar nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Më tej, pas ankimit të ushtruar dhe vendimit gjyqësor për kthimin e çështjes dhe vijimin e disa hetimeve të tjera kjo çështje është hetuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka ezauruar detyrën e lënë nga gjykata për kryerjen e aktekspertimit topografik dhe teknik (për AMTP), duke qenë se çështja në themel kishte problematikë pronësore dhe në përfundim ka vendosur gjithashtu pushimin e çështjes, vendim i cili është ligjëruar⁶⁸ më tej edhe nga gjykata nën ankimin e ushtruar në mënyrë të përsëritur nga denoncuesi. Në kushte të tilla, duket se nuk identifikohen fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

5. Denoncimet⁶⁹ e shtetasës M. Sh.

5.1 Denoncuesja (vajza e shtetasës L. Sh.) ankohet për zvarritje të pajustificuar të hetimeve lidhur me procedimin penal nr. *** (për aksidentin e shkaktuar shtetasës L.Sh.). Pretendohet se pa u kryer hetimet e duhura janë lejuar një sërë shkeljesh e zvarritjesh prej subjektit dhe gati një vit pas ngjarjes është marrë vendim për pezullimin e hetimeve, i cili pas ankimit të ushtruar nga shtetasja Sh. është prishur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë me vendimin nr. ***, datë 10.9.2019, duke iu kthyer aktet prokurorit për vazhdimin e hetimeve. Por, edhe pse aktet janë përcjellë për hetime të mëtejshme që në datën 15.10.2019, denoncuesja pretendon se në dijeninë e saj kjo çështje është lënë pas dore, edhe pse hetimet kanë qenë tej mase të vonuara.

5.2 Në referim të pretendimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesja, Komisioni i ka kërkuar⁷⁰ subjektit shpjegimet përkatëse dhe vërtetimin e veprimeve hetimore nëpërmjet dokumentacionit hetimor në dosjen penale.

⁶⁸ Me vendimin nr. ***, datë 31.10.2017, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

⁶⁹ Denoncimet nr. *** prot., datë 13.12.2019, dhe nr. ***prot., datë 9.9.2021.

⁷⁰ Me pyetësorin nr. 3, datë 1.7.2021.

5.3 Në përgjigjen e tij⁷¹, subjekti ka shpjeguar se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore për zbardhjen e ngjarjes, që nga regjistrimi i procedimit penal nr. ***, në datën 16.7.2018, marrjen e vendimeve përkatëse për këqyrjen e kamerave në ambientet përreth vendit ku ndodhi aksidenti, kryerjen, verifikimet dhe marrjen e pamjeve filmike (nga të cilat nuk është bërë e mundur të evidentohen pamje të aksidentit), administrimin e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor lidhur me dëmtimet e shtetases L. Sh., bërjen e ballafaqimeve mes punonjësve të policisë dhe shtetases M. Sh. lidhur me pretendimet e saj, si dhe kryerjen e veprimeve të tjera hetimore.

5.4 Më tej, subjekti ka deklaruar se në kushtet kur edhe pse janë kryer veprimet hetimore, por nuk është bërë i mundur identifikimi i personit që ka shkaktuar aksidentin, me vendimin e datës 10.7.2019 është vendosur pezullimi i hetimeve. Lidhur me zvarritjen e pretenduar të hetimeve, subjekti deklaroi se, përveç ngarkesës së lartë në punë, është vlerësuar dhe përpjekur maksimalisht edhe mbi pretendimet e shtetases M. Sh. për identifikimin e autorit të veprës penale.

5.5 Sa i përket ankimit të shtetases L. Sh. ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve, subjekti ka deklaruar se *pasi janë zbatuar detyrat e lëna nga gjykata, me vendimin e datës 7.8.2020 është vendosur pezullimi i hetimeve, duke qenë se autori i veprës penale nuk ishte zbuluar. Kundër këtij vendimi ka bërë përsëri ankim në gjykatë shtetasja L. Sh.. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. **, datë 9.10.2020, vendosi rrëzimin e kërkesës së kërkujes L. Sh. .*

5.6 Në vijim, subjekti jep sqarime⁷² edhe lidhur me pretendimet për orarin e aksidentit, sigurimin e pamjeve filmike dhe veprimet e tjera hetimore.

5.7 Subjekti, në mbështetje të pretendimeve të tij, ka dërguar, bashkëlidhur përgjigjeve, fashikullin e procedimit penal nr***të vitit 2018 dhe vendimin nr***, datë 9.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

5.8 Rezulton⁷³ se ngjarja e referuar nga denoncuesja (aksidenti) ka ndodhur në datën 12.7.2018, rreth orës 11:15. Me urdhrin datë 16.7.2018 është regjistruar procedimi penal për veprën penale “largim nga vendi i aksidentit”, parashikuar nga neni 273 i Kodit Penal (identifikuar si procedimi penal nr. ***, datë 16.7.2018).

5.9 Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti, në datën 10.7.2019 ka marrë vendim për pezullimin e procedimit penal. Ndaj këtij vendimi personi i dëmtuar L. Sh. (ka lidhje me denoncuesen M. Sh.) ka bërë ankim në datën 19.7.2019, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

5.10 Në vijim, gjykata, me vendimin nr. ***, datë 10.9.2019, ka vendosur pranimin e ankimit të ankueses L. Sh. dhe prishjen e vendimit datë 10.7.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** dhe rifillimin e hetimeve. Kundër këtij vendimi nuk është lejuar ankesë.

⁷¹ Dërguar me e-mail-in e datës 7.7.2021.

⁷² Me pyetësin nr. 3, datë 1.7.2021.

⁷³ Referuar ankimit datë 19.07.2019, të denoncueses në gjykatë, ndaj vendimit të subjektit për pezullimin e procedimit penal, datë 10.7.2019 dhe vendimit nr. ***, datë 10.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

5.11 Nga analizimi i vendimit nr. ***, datë 10.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, referencë për ngjarjen e ndodhur rezulton të jetë data 12.7.2018, rreth orës 11:15. Ndërkohë që subjekti, në përgjigjen ndaj pyetësorit nr. 3, por edhe në veprimet procedurale të kryera, të cilat kanë qenë mjaft të rëndësishme për zbulimin e autorit (siç është edhe konfiskimi i pamjeve filmike), referon si orar të ngjarjes dhe, për pasojë, ka siguruar pamjet filmike duke filluar nga ora 12:00 deri në orën 13:00.

5.12 Vendimi për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike, i datës 24.7.2018, referon marrjen e pamjeve filmike që ndodhen në serverët e ABI Bank, lagjja “***”, për datën 12.7.2018, ora 11:30 deri në orën 12:30. Gjykata ka evidentuar faktin se veprimet e kryera janë “pjesërisht të gabuara dhe jo saktësisht të zbatuara”, pasi intervali kohor i cilësuar në vendim nuk paraqet asnjë interes për hetimin, sepse i përket kohës 10-15 min. pas ndodhjes së aksidentit.

5.13 Të njëjtin konstatim ka bërë gjykata edhe për pamjet filmike të ndodhura në Postën Shqiptare, filiali Gjirokastër, lidhur me orarin e pamjeve filmike dhe kryerjen e këqyrjes në afatin e përcaktuar nga prokurori. Ndërsa në procesverbalin e këqyrjes, datë 1.8.2018, ora 12:45, nuk rezulton të jetë përshkruar se çfarë rezulton nga përmbajtja e këtyre pamjeve.

5.14 Sa i përket vendimit për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike, datë 24.7.2018, në serverët e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër, për të njëjtin orar si më sipër gjykata evidenton se nuk rezulton të jetë zbatuar, edhe pse marrja e këtyre pamjeve ishte shumë e rëndësishme për ecurinë e hetimit.

5.15 Për vendimin për këqyrjen dhe marrjen e pamjeve filmike, datë 24.7.2018, që ndodhen në firmën private “T.” (lagjja “***”, Gjirokastër), gjykata ka evidentuar se nuk ekziston asnjë akt në dosje që të vërtetojë zbatimin ose arsyt e moszbatimit të këtij vendimi.

5.16 Gjithashtu, në vendim evidentohet pretendimi i të dëmtuarës se nga prokuroria nuk janë marrë në pyetje personat që kanë qenë të pranishëm, në cilësinë e tyre si punonjës të institucioneve apo bizneseve, në afërsi të vendit të ngjarjes dhe nuk është vlerësuar si e nevojshme marrja e pamjeve filmike të kamerave të ADISA dhe NBG Bank, të ndodhura afër vendit të ngjarjes.

5.17 Në përfundim, gjykata ka vendosur pranimin e ankimit të palës ankuese, prishjen e vendimit datë 10.7.2019, të prokurorisë për pezullimin e hetimeve të procedimit penal nr*** dhe rifillimin e hetimeve.

5.18 Gjithashtu, gjykata ka lënë edhe detyra lidhur me marrjen e pamjeve filmike, që më parë nuk ishin marrë (evidentuar edhe në ankimin e palës së dëmtuar), pyetjen e disa shtetasve dhe ripyetjen e disa të tjerëve.

5.19 Në vijim, në zbatim të detyrave të lëna në vendimin nr***, datë 10.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, subjekti ka rifilluar hetimin dhe kryerjen e veprimeve hetimore, por referuar konkretisht veprimeve mbi sigurimin e pamjeve filmike nga institucione të tjera (evidentuar në vendim) kjo ka qenë e pamundur si pasojë e kohës së gjatë që kishte kaluar nga momenti i ndodhjes së ngjarjes.

5.20 Më tej, me vendimin e datës 7.8.2020, subjekti ka vendosur sërish pezullimin e procedimit penal, me arsyetimin se⁷⁴: *“Nuk rezulton se mbetet të kryhet ndonjë veprim tjetër hetimor nga ana jonë”*.

5.21 Ky vendim i është komunikuar shtetases L.Sh. në datën 17.9.2020 dhe në datën 23.9.2020 kjo e fundit ka paraqitur ankim kundër vendimit të pezullimit të procedimit penal, datë 7.8.2020.

5.22 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 9.10.2020, ka vendosur rrezimin e ankimit të ankueses L. Sh., vendim ky i paankimueshëm.

5.23 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime, pasi: (i) dukej se prej tij ishin kryer pjesërisht veprime të gabuara dhe jo të sakta në hetimin e kësaj çështjeje dhe më konkretisht lidhur me intervalin kohor të pamjeve filmike të kërkuara nga prokuroria apo lidhur me mosmarrjen në pyetje të personave që kanë qenë të pranishëm në vendin e ngjarjes, etj., duke iu referuar përshkrimeve të bëra në pikat 5.11 deri 5.16; (ii) dukej se prej tij nuk ishin ushtruar në mënyrë korrekte përgjegjësitë dhe kompetencat e tij, parashikuar nga nenet 24/1/2 (funksionet e prokurorit); si dhe (iii) të qartësonte ecurinë e pezullimit të procedimit/statusin aktual të çështjes.

5.24 Subjekti, në prapësimet e tij, ndër të tjera, ka shpjeguar: *“Së pari, Komisioni pretendon se nga ana ime është gabuar në orarin e kërkuar të pamjeve filmike, pasi nga të dhënat për ngjarjen rezulton se ajo ka ndodhur në datën 12.7.2018, rreth orës 11:30, ndërkohë që pamjet filmike janë siguruar nga ora 12:00 deri në orën 12:30.*

Lidhur me këtë pretendim, po argumentoj se:

- a) *Pamjet filmike të siguruara nuk janë marrë në intervalin kohor 12:00 – 12:30, por janë ato të siguruara nga ora 11:30 – 12:30 (shihni procesverbalin në f. 25 të fashikullit nr. 1, ku përshkruhet marrja e pamjeve filmike në Zyrën e Postës, lagjja ‘***).*
- b) *Në vendimet për këqyrjen e pamjeve filmike, pamjet filmike janë kërkuar për intervalin 11:30 – 12.30, pasi referuar informacionit të referimit nga oficeri i policisë gjyqësore thuhet se rreth orës 12:00 ai është njoftuar për aksidentin e ndodhur. Po kështu, edhe në raportin e ngjarjes, ora e përafërt e ngjarjes është vendosur ora 12:00. Në këto kushte, në vendimet për marrjen e pamjeve filmike, duke menduar edhe gabimin e përafërt që mund të bëhej, me të drejtë janë përcaktuar intervalet kohore nga 30 minuta para dhe pas orës së referimit. Vetë e dëmtuara, si dhe dëshmitarja S. C., në deklarin e tyre nuk kishin përmendur orën e ndodhjes së aksidentit, por faktin se drejtuesi i automjetit kishte ndaluar dhe i kishte pyetur nëse kishin nevojë për ndihmë, ndërsa e dëmtuara L. Sh. i kishte thënë se nuk kishte gjë. Për të gjitha këto rrethana që përmenda më sipër ka qenë plotësisht e arsyeshme që kërkimi i pamjeve të ishte brenda intervalit të sipërcituar.*
- c) *Nga pamjet e marra nga Zyra e Postës Shqiptare nuk rezultoi ndonjë e dhënë e vlefshme për hetimin, prandaj edhe rezultatet e saj nuk janë përshkruar në procesverbalin përkatës dhe në aktet e tjera.*

⁷⁴ Vendim për pezullimin e procedimit penal, datë 7.8.2020, i subjektit.

- d) *Veprimet për marrjen e kamerave janë ezauruar në ABI Bank dhe Zyrën e Postës Shqiptare. Nga ABI Bank na është bërë e ditur se nuk disponojnë pamje të mjeteve të lëvizshme në rrugë. Nga pyetja e shtetasve Ç. Ç. dhe A. Ç., të cilët kanë dyqanin berberhane, rezultoi se kamerat e vendosura në këtë vend nuk transmetonin pamjet e rrugës ku lëviznin mjete dhe kamera e jashtme ka fushëpamje nga dyert e dyqaneve dhe jo nga bulevardi i lagjes ‘***’. Këtë fakt, sipas shtetasës M. Sh., berberi ia ka pohuar edhe asaj, siç rezultoi nga deklarimi i kësaj shtetaseje.*
- e) *Pretendimi i shtetasës L.Sh., se nuk janë marrë në pyetje të gjithë personat që kishin dijeni në lidhje me ngjarjen, nuk qëndron. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër janë pyetur fillimisht shtetasit L. Sh., S.C., Ç. Ç., M.Sh., B. F., A. Ç., K. M., A.B. . D.M. dhe E.Xh. . Janë pyetur të gjithë dëshmitarët e pretenduar nga shtetasja M. Sh. që kishin dijeni për faktin, si dhe ata që mund të kishin dijeni sipas të dhënave që jepeshin. Edhe shtetasja Z. Ç., pas prishjes së vendimit për pezullimin e hetimeve, është pyetur më vonë dhe ka deklaruar fakte të cilat nuk kanë çuar në identifikimin e autorit të veprës penale.*

Nisur nga sa më sipër, pavarësisht se e dëmtuara L. Sh. dha versionin se personi që e goditi nuk u largua, si dhe dëshmitarja tjetër S. C. (e motra), hetimet tona nuk u reduktuan vetëm në këtë drejtim, duke ngritur edhe një tjetër version hetimor racional se dëshmitarë apo edhe vetë personi që do identifikohet mund të pohojn largimin. Pamjet filmike janë kërkuar në mirëbesim, nisur nga orari i referuar nga Policia Gjyqësore dhe ka qenë një kërkim i arsyeshëm. Aktualisht kjo çështje penale vazhdon të jetë në statusin ‘e pezulluar’”.

5.25 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, dokumentacionit të administruar në fashikullin penal, vëren se në çështjen objekt hetimi nuk ka treguar përkushtimin e duhur në drejtim të zbardhjes së situatës në kohë, për shkak të rrethanave që e diktonin atë. Subjekti, pasi ka urdhëruar në datën 3.9.2018 delegimin e disa veprimeve hetimore oficerit të policisë gjyqësore, me qëllim zbardhjen e çështjes, nga aktet e administruara në fashikullin penal ka rezultuar se nuk ka ndjekur në vijimësi kryerjen e tyre.

a. Subjekti ka urdhëruar administrimin e aktekspertimit mjeko-ligjor të të dëmtuarës L. Sh., marrjen e pamjeve filmike në ambientet përreth vendit ku ka ndodhur aksidenti, këqyrjen e këtyre pamjeve, kryerjen e ekspertimit autoteknik për të përcaktuar shkakun e aksidentit, pyetjen e personit që ka dijeni për kryerjen e veprës penale (shtetasen Z. Ç.), etj. Ajo që evidentohet në këtë rast është fakti se subjekti, teksa ka urdhëruar marrjen e pamjeve filmike, duke iu referuar orës 12:00, nisur nga koha kur është dhënë informacioni nga salla operative për aksidentin e ndodhur shtetasës L. Sh., nën logjikën e përdorur se kërkimi është bërë 30 minuta para dhe pas kësaj reference (orës 12:00), ka pasur të gjithë mundësitë për t’u përqendruar në dëshminë mjeko-ligjore nr. ***, datë 12.7.2018, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, provë e administruar në dosje, e realizuar në datën e ndodhisë së ngjarjes, për t’i marrë pamjet filmike bazuar në orarin e pasqyruar në këtë akt, ku konkretisht citohet: “[...] ekzaminimi i bërë të dëmtuarës L. Sh. në urgjencën e spitalit është bërë në datën 12.7.2018, në orën 11:40”. Në këtë rast, logjika e përdorur nga subjekti (30 minuta para dhe pas orarit referent 11:40) për marrjen e pamjeve filmike të aksidentit të ndodhur

do të mund të ishte më produktive. Po ashtu, edhe nëse do të merrej në konsideratë fakti se ky akt mund të ishte depozituar në vonesë të kësaj date (12.7.2018), përsëri subjekti ka pasur të gjithë kushtet dhe rrethanat që të rishikte urdhërimin e marrjes së pamjeve filmike. Vetëm nën këtë vlerësim ky rishikim do të ishte më real dhe produktiv, por njëkohësisht edhe në përputhje me legjislacionin specifik, sa i përket administrimit të sistemeve të kamerave (CCTV), konkretisht udhëzimi nr***, datë 5.3.2010, mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” (miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale). Në këtë akt nënligjor është parashikuar se afati maksimal i ruajtjes së pamjeve filmike është deri në dy muaj dhe pas kalimit të kësaj periudhe të dhënat do të fshihen. Ky afat jo detyrimisht përputhet me gjendjen faktike të ruajtjes së pamjeve e cila varet nga gjendja faktike e situatës teknike të çdo institucioni publik ose privat. Në këtë argument vetiu krijohen vështirësi në kryerjen e detyrave të lëna nga gjykata pas kthimit të çështjes, pikërisht lidhur me marrjen e këtyre pamjeve filmike, për shkak të periudhës që është dashur për t’u gjykuar e përfunduar çështja në gjykatë, që nënkupton tejkalimin e afatit dymujor të ruajtjes së të dhënave. Ky moment (pra referenca e gabuar e orarit) ka mbetur i rëndësishëm dhe në disfavor të zbardhjes së çështjes për të gjithë urdhërimet e bëra nga subjekti për marrjen dhe administrimin e pamjeve filmike në disa institucione përreth vendit të aksidentit, si ABI Bank, Posta Shqiptare, firma private “T.” dhe Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë.

b. Në vazhden e moskryerjes së hetimeve të plota është edhe: (i) fakti i mosmarrjes në pyetje të shtetases Ç.; (ii) pezullimi i çështjes, jo vetëm pas një viti (datë 10.9.2019) nga regjistrimi i saj, por edhe pa pritur përgjigjet e kërkimeve të bëra lidhur me marrjen dhe këqyrjen e pamjeve filmike nga disa institucione (ABI Bank, Drejtoria Vendore e Policisë, firma private “T.”).

c. Megjithëkëtë, trupi gjykues, në analizën e kësaj çështjeje, duke vepruar nën dritën e objektivitetit dhe proporcionalitetit, vëren se qasja dhe veprimet e subjektit (sikurse ky i fundit i ka cituar edhe në seancën dëgjimore) mund edhe të jetë ndikuar apo prirur nga deklarimi dhe gjendja shëndetësore e të dëmtuarës, nga ku rezulton se vetë ajo në procesverbalin e datës 12.7.2018 (datë në të cilën ka ndodhur ngjarja) ndër të tjera, ka cituar: “[...] shoferi ka ndaluar, e ka pyetur për gjendjen shëndetësore dhe i ka ofruar ndihmë për ta çuar në spital dhe se vetë ajo i është përgjigjur se nuk ka problem dhe se nuk ka nevojë për ndihmë. [...] pas kontrollit nuk pata asnjë problem dhe u largova në banesë”.

ç. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson se në këtë rast problematikat duken evidente pa një logjikë hetimi në drejtim të aftësive të subjektit në rolin e prokurorit dhe se nuk mund të kanalizohen të lidhura me bindjen e brendshme apo me zëvendësimin e logjikës së subjektit dhe, për rrjedhojë, çmohet se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk justifikojnë moskryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme, sipas vlerësimit të fakteve që dilnin në dinamikën e ngjarjes në kohë reale.

d. Trupi gjykues, në tërësi, vëren se subjekti nuk ka ndërmarrë logjikisht hetimin sipas kërkesave ligjore për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesat e parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

6. Denoncim⁷⁵ i përfaqësuesit me prokurë të të miturës A.M.

6.1 Në denoncimin e përfaqësuesit me prokurë të të miturës A. M., dhënë nga prindërit e saj, pretendohet se subjekti, me cilësinë e prokurorit, ndryshe nga se kishte theksuar në kërkesën dhe në parashtrimet para gjykatës lidhur me masën e sigurimit (“arrest në burg” me afat 45 ditë) ndaj personit nën hetim M. D. (pasi dyshohej të kishte kryer veprën penale “ngacmime seksuale”), nuk ka apeluar vendimmarrjen e dyshimtë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për mosmiratimin e kësaj kërkesë. Denoncuesi ka parashtruar se në kërkimin e prokurorit është argumentuar se: (i) dyshimi për kryerjen e kësaj vepre është i arsyeshëm dhe i bazuar në prova; (ii) fakti ka një peshë shumë të lartë dhe rrezikshmëria shoqërore e të pandehurit është e lartë; (iii) rrezikshmëria e veprës penale është relativisht e lartë; si dhe (iv) ka rrezik që personi nën hetim të largohet dhe të manipulojë provat.

6.2 Subjektit i është kërkuar⁷⁶ të japë shpjegime, duke u përqendruar tek pretendimet e denoncuesit, të qartësojë në detaje rrethanat që kanë diktuar mosankimimin e vendimit gjyqësor prej tij, si dhe të depozitojë dokumentacion dhe kopje të fashikullit përkatës.

6.3 Subjekti, ndër të tjera, ka sqaruar:

- *“Lidhur me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal për shtetasin M. D., nga ana ime në përpilimin e kërkesës janë mbajtur parasysht këto fakte: (a) rëndësia e faktit ishte e tillë sa dëshmonte për një rrezikshmëri të lartë; (b) kishte të dhëna për kryerje të veprës penale (thëniet e të miturve, përfshirë viktimën). Lidhur me masën e sigurimit, duke qenë se shtetasi M. D. ishte mësues në shkollë dhe e vazhdonte detyrën, lënia e tij momentet e para i lirë, do të krijonte pasoja edhe në drejtim të provave reale, siç ishin këqyrjet në shkollë apo manipulim i dokumenteve. Nga ana tjetër, faza në të cilën ndodhej procedimi, ku si rrethana ishin vetëm prova verbale, diktonte nevojën e kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, të cilat do të konfirmonin apo rrëzonin provat e marra deri në atë moment. Për të gjitha arsyet e sipërcituara është zgjedhur masa e sigurimit personal “arrest në burg”, me afat 45 ditë, parashikuar nga nenet 238 e 245, paragrafi 1, germa “ç” e Kodit të Procedurës Penale.*
- *Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 8.6.2018, vendosi vlerësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës shtrënguese “detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” për shtetasin M. D. . Ajo caktoi edhe masën ndaluese të “ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë profesionale” për këtë person, sipas nenit 240 të Kodit të Procedurës Penale. Në kushtet kur gjykata vendosi edhe masën ndaluese, mundësia e ndikimit mbi provat sipas bindjes sime u neutralizua. Gjithashtu, rrezikshmëria e personit në eventualitetin e kombinimit të të dy masave, ndaluese dhe shtrënguese, duke pasur parasysht tipologjinë e veprës penale, faktin që mosushtrimi i detyrës do ta largonte nga kontakti me fëmijët personin dhe nga ndikimi mbi provat, më bindi se vendimmarrja e gjykatës ishte e drejtë. Nga ana tjetër, nuk kishte të dhëna për mundësinë e kryerjes së veprave të tjera nga ky*

⁷⁵ Denoncim nr***prot., datë 3.7.2018.

⁷⁶ Me pyetësorin nr. 3, datë 1.7.2021.

person në të ardhmen. Përfaqësuesi me prokurë i të miturës A.M. e quan vendimmarrjen e gjykatës të dyshimtë, ndërkohë që në botën e civilizuar masat e sigurimit “arrest në burg” konsiderohet si ultima ratio dhe mbizotëron parimi favor libertatis⁷⁷. Këndvështrimet e respektimit të këtij parimi nuk ngelen në një proces statik, por në një përballje kritike mes provave të mbledhura e diskutimit nga pozita të ndryshme procedurale.

- *Pas përfundimit të hetimeve, çështjen e kam dërguar për gjykim dhe kam kërkuar dënimin e shtetasit M. D. . Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr***, datë 29.3.2021, e deklaroi fajtor të pandehur dhe e dënoi me 4 (katër) vjet burgim, vendim i cili nuk ka marrë formë të prerë”.*

6.4 Subjekti ka depozituar: fashikullin e procedimit penal nr***të vitit 2018; vendimin nr. ***, datë 29.3.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; dhe diskutimin përfundimtar të prokurorit.

6.5 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, vërejt se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore të renditura në urdhrat përkatës dhe ka zgatur afatet lidhur me administrimin e disa akteve të vlerësuara për zbardhjen e çështjes. Çështja ka nisur prej qershorit të vitit 2018 dhe ka përfunduar së hetuari në janar të vitit 2019. Subjekti ka kërkuar fillimisht arrestin me burg me afat 45 ditë ndaj të akuzuarit dhe gjykata, sikurse edhe është shprehur në shpjegimet e tij, ka vlerësuar masën e “detyrimit të paraqitjes në Policinë Gjyqësore” si dhe “ndalimin e ushtrimit të profesionit”. Në datën 21.1.2019 subjekti ka njoftuar përfundimin e hetimeve dhe më tej çështja i është dërguar gjyqësorit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 29.3.2021, pas diskutimeve përfundimtare të organit të akuzës, ku është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit për kryerjen e veprës penale “vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal dhe dënimin me 5 vjet burgim, ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e tij me 4 vjet burgim. Në lidhje me statusin aktual të vendimmarrjes së gjyqësorit, subjekti ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 3.9.2021, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ku pasqyrohet fakti se çështja vijon të jetë në proces gjyqësor në këtë gjykatë.

6.6 Për sa më sipër, trupi gjykues nuk vërejt fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

7. Denoncim⁷⁸ i shtetasit F.D.

7.1 Në denoncimin e tij shtetasi F.D. ka kallëzuar çështje të bëra publike nga emisionet investigative “Fiks Fare” dhe “Stop”, me qëllimin, sipas tij, në investimin për të luftuar korrupsionin. Në këtë drejtim bëhet prezent çështja e evazionit fiskal për shumën rreth 1.000.000 euro nga ana e sipërmarrësit I. B., e trajtuar nga emisioni investigativ “Stop” në TV Klan. Rasti identifikon prokurorin Çafka se ka mbyllur këtë dosje. Po ashtu, rasti i radhës ka të bëjë me

⁷⁷ Në ndryshim nga parimi *periculum libertatis* që e shikon arrestin në burg si mjet të domosdoshëm, por gjithmonë edhe si mjet i fundit, kur janë kushtet për zbatim.

⁷⁸ Denoncim nr. *** prot., datë 11.1.2021.

çështjen e ankuar nga shtetasi F. Zh., i cili pretendon se dy djemtë e tij janë dënuar padrejtësisht. Ndër të tjera, identifikon sekuenca të komunikimit me subjektin.

7.2 Në lidhje me këtë denoncim, subjektit i është kërkuar⁷⁹ të japë shpjegime të detajuara për secilin rast, si dhe të depozitojë dokumentacionin përkatës.

7.3 Lidhur me këtë denoncim, subjekti ka sqaruar se:

- *“Kallëzimi i pretenduar për evazion fiskal, kallëzim i bërë nga ana e shtetasit Gj. B. është në vazhden e kallëzimeve penale që ky person dhe shtetasi I. B. i biri i Gj.), kanë bërë reciprokisht kundër njëri-tjetrit. Kallëzimi penal i bërë nga ky person ka marrë nr. ***, datë 1.10.2019. Bashkëlidhur janë dorëzuar edhe disa shënime të pretenduara se i përkisnin shtetasit I. B. dhe që sipas kallëzuesit hidhnin dyshime për transaksione të pamiratuara. Me vendimin e datës 14.10.2019 është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga ana ime, me argumentin se rrethanat e faktit nuk formonin elementet e figurës së veprës penale. Vlen të theksohet se konflikti mes shtetasve Gj.B. dhe djalit të tij I. B. ka qenë i përshkallëzuar, ku të dy personat kishin pretendime ndaj njëri-tjetrit. Në ambientet ku ushtrohej aktivitet tregtar ishin të regjistruara dy subjekte, ku shtetasi I. B. tek subjekti ‘Gj.’ sh.p.k. ishte administrator dhe ortak në masën 50 % me babanë e tij Gj., kurse tek subjekti tjetër ‘K.’ sh.p.k. ishte ortak i vetëm bashkëshortja e tij. Këto dy subjekte kanë të njëjtin objekt veprimtarie. Si rrjedhojë e këtij konflikti, në kohën kur është paraqitur kallëzimi penal nr. ***, datë 1.10.2019, ishin regjistruar 11 (njëmbëdhjetë) procedime penale , ku objekt i hetimit të tyre kanë qenë:*
 - a) *verifikimi i pretendimeve për vjedhje malli;*
 - b) *verifikimi për pretendimin e shpërdorimit të kompetencave nga administratori i ‘Gj.’ sh.p.k., shtetasi I.B.;*
 - c) *verifikimet për fshehje të ardhurash nga subjektet dhe njoftimi i organeve tatimore për kryerje veprimesh;*
 - d) *verifikimi i dokumentacionit;*
 - e) *hetimi i fakteve të pengimit të hyrjes në objekt dhe dëmtimeve fizike në shëndetin e personave.**Nga ana jonë është bashkëpunuar me organet tatimore për të bërë një kontroll të thelluar në këto dy subjekte.*
- *Lidhur me mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, datë 1.10.2019, vlen të theksohet se fakti i gjetjes së shënimeve në faturat e pamiratuara nuk përbën në vetvete veprim të fshehjes së të ardhurave, pasi këto shënime nuk përbëjnë dokumentacion kontabiliteti të miratuar. Lidhur me pretendimet për evazion, ky pretendim ishte objekt hetimi në 11 (njëmbëdhjetë) procedimet e regjistruara më parë. Megjithatë, nga ana jonë është bërë një vlerësim i dytë dhe është pranuar kërkesa në gjykim për prishjen e vendimit të mosfillimit të kallëzimit penal nr. ***, datë 1.10.2019. Ky qëndrim është mbajtur pasi është vlerësuar që*

⁷⁹ Me pyetësin nr. 3, datë 1.7.2021.

*për këto shënime vlerësimi do të bëhej në raport me provat e tjera. Mbi këtë bazë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 26.2.2020, vendosi detyrimin për regjistrimin e procedimit penal. Është regjistruar procedimi penal nr. ***, në datën 20.5.2020, për veprën penale të 'fshehjes së të ardhurave', parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal. Aktualisht, ky procedim penal është bashkuar me 25 procedimi penale të tjera në një procedim penal të vetëm, me nr. *** të vitit 2019, për veprat penale të parashikuara nga nenet 134, 155, 180, 164, 277, 272, 186, 135, 320 dhe 181 të Kodit Penal.*

- *Në funksion të hetimeve, në bashkëpunim me autoritetet tatimore, është bërë kontroll për të dy subjektet dhe rezultati është administruar në fashikullin e procedimit penal të bashkuar. Mënyra e trajtimit mediatikisht të çështjes, sipas pikëpamjes sime, nuk ishte i drejtë. Lidhur me motivet e shqetësimit e trajtimit të çështjes në emisionin 'Stop' në TV Klan, i jam drejtuar me shkresën nr. ***, datë 23.1.2020, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ku dhe kam dhënë informacion dhe kam shprehur shqetësimet përkatëse për transmetimin e problemit jo në mënyrë të saktë dhe duke pretenduar evazion me shifra konkrete, pa u bërë më parë kontrolli nga organet e hetimit dhe ato tatimore, të cilat kanë dalë në përfundimet përkatëse.*

Aktualisht ky procedim penal është në fazën e hetimeve paraprake për shkak të volumit të lartë të veprimtarisë hetimore”.

7.4 Subjekti ka depozituar vërtetimin e Zyrës së Regjistrimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë lidhur me procedimet penale të regjistruara për këto çështje dhe vendimin nr***, datë 26.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ndërsa ka informuar se procedimi penal i bashkuar, me nr. *** i vitit 2019, është në fazën e hetimeve paraprake dhe se nuk mund të vendoset në dispozicion kopje e akteve të këtij procedimi penal.

7.5 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁸⁰, pasi dukej se kishte vepruar në kundërshtim me nenin 73/2/3 të ligjit nr. 96/2016, për shkak se nuk kishte kryer hetime lidhur me çështjen për të cilën kishte vendosur mosfillimin e saj, si: (a) kërkimin e informacionit nga institucionet bankare, etj.; apo edhe (b) sekuestrimin e provave materiale, si dokumentet ligjore të shoqërive tregtare, problematika këto të pasqyruara dhe të lëna si detyrë për t'u kryer nga vendimi gjyqësor, si dhe të depozitohet vendimi e mosfillimit⁸¹ të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, datë 1.10.2019.

7.6 Ndërkohë, në emisionin investigativ “Stop” në TV Klan⁸², ndër të tjera, në komunikimin e subjektit me gazetarin, pasi është pyetur, subjekti duket të ketë cituar shprehimisht (pra për çështjen e mësipërme të qartësuar se është vendosur mosfillim): “[...] Po është bërë mosfillim..., po nuk e di, është bërë lapsus..., nuk e di, është bërë lapsus”.

⁸⁰ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁸¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 291, vendimi për mosfillimin e procedimit (shtuar pikat 3, 4 dhe 5 dhe fjalë në pikën 1, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017): “1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”.

<https://www.youtube.com/watch?v=ge0uQ8EwB8o>

7.6.i Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime.

7.6.ii Subjekti, përveçse ka dhënë shpjegime në pyetësin nr. 3, ka shtuar, si vijon:

- a) *Ngarkesa në punë ka qenë shumë e lartë, pasi nga shtatori i vitit 2019 deri në shkurt të vitit 2020, Prokuroria e Rrethit Gjirokastrë ka funksionuar me vetëm dy prokurorë (Juljan Çafka e E. K.), ku duhet t'i përgjigjej një ngarkese jashtë çdo standardi logjik.*
- b) *Në vetvete, provat e sekuestruara nuk përfaqësojnë provueshmëri të ndonjë fakti, por vetëm shërbenin si shtojcë e ndonjë përfundimi që duhet të arrihej në hetimet tashmë të filluara.*
- c) *Në këto kushte, kishte dy mundësi për organin procedues, ose të fillohej edhe ky procedim penal dhe të kryheshin hetime, ose të vendosej mosfillimi i tij dhe provat shkresore të sekuestruara të administroheshin nëpërmjet këqyrjes në procedimet e nisura. Brenda këtyre dy opsioneve, organi i prokurorisë kishte hapësirë vlerësimi.*
- d) *Pretendohet se mosfillimi është kryer pa bërë hetime, në kundërshtim me ligjin nr. 96/2016, neni 73, paragrafi 2 dhe 3. Veprimtaria hetimore rregullohet në bazë të Kodit të Procedurës Penale. Në këtë aspekt, edhe përcaktimet e nenit 73/2/3 të ligjit nr. 96/2016 duhet të vijnë në harmoni me të gjitha drejtimit që përcakton Kodi i Procedurës Penale në veprimtarinë hetimore. Në rastet kur prokurori çmon se kallëzimi i paraqitur nuk përmban të dhëna të rëndësishme për nisjen e hetimeve, mundet që të vendosë mbi bazën e akteve që janë paraqitur, të cilat nuk përmbajnë të dhëna apo indicie që kërkojnë një proces të ndërlikuar e të gjatë verifikimi. Në këto raste, prokurori mjaftohet me një arsyetim de plano të këtyre rrethanave⁸³. Më sipër, unë parashtrova faktin se pse vendimi i mosfillimit të procedimit penal ishte i drejtë dhe gjithashtu edhe faktin se hetimi i çështjes ishte i lidhur me procedime të mëparshme të filluara. Lidhur me procedimet penale të filluara më parë, iu kam paraqitur një vërtetim për numrin e procedimeve të ndërmarra dhe objektin e tyre të hetimit. Provat shkresore, të cilat ishin shënime të njërit nga personat, nuk kanë në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore", vlerë ligjore për ngarkim të detyrimeve tatimore. Megjithatë, në një version të besueshëm, një person që mban shënime, me shumë mundësi nuk i mban shënimet pa një qëllim të caktuar, por mund të ketë një arsye të qenësishme. Në këtë kuptim, unë më pas prandaj kam qenë dakord me shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, kam regjistruar procedim dhe kam bashkuar atë me procedimet e tjera.*
- e) *Lidhur me çështjen penale të bashkuar, me nr. *** të vitit 2019, për këtë çështje penale është përpiluar kërkesa për dërgimin për gjykim të të pandehurit I. B., për veprën penale "shpërdorim të kompetencave", parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetases L. B., për veprën penale "fshehje e të ardhurave", parashikuar nga neni 180/1 i Kodit Penal dhe për shtetasin Gj. B., i akuzuar për veprën penale të "vetëgjyqësisë", parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.*

⁸³ Shihni vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, i Gjykatës së Lartë.

7.6.iii Subjekti, lidhur me komunikimin me gazetarin e emisionit investigativ “Stop”, ku shprehet se është bërë lapsus, ka shpjeguar: *“Në sqarimin që i kam bërë këtij personi, që është prezantuar si gazetar, kam pasur parasysh pikërisht mundësinë që procedimi edhe mund të regjistrohej me qëllim administrimin e provave dhe kam zgjedhur këtë rrugë më pas. Por mundet edhe të administroja provat me këqyrje apo sekuestro në fashikujt e tjerë të procedimeve penale të bashkuara. Ky është ‘lapsusi’ i përmendur nga ana ime. Ndërkohë që hetimi i çështjes penale nr. *** të vitit 2019 (i bashkuar) tregon se gfarë veprimesh janë bërë dhe si kanë rezultuar rrethanat e faktit”*.

7.6.iv Subjekti ka depozituar: (i) vendimin e mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, datë 1.10.2019; (ii) vërtetimin për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2019; si dhe (iii) vendimin nr. ***, datë 26.2.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

7.7 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të administruar, vëren se çështja, objekt hetimi, është pasojë e disa procedimeve të njëpasnjëshme të regjistruara për shkak të kallëzimeve reciproke midis denoncuesit dhe familjarëve të tij, të cilët administrojnë biznese veçmas apo në ortakëri. Gjithsesi, rasti në fjalë për të cilin subjekti fillimisht ka vendosur mosfillimin e çështjes, nën kontekstin e interpretimit të bërë prej tij se çështja ishte e lidhur me procedimet e mëparshme të cilat ishin regjistruar dhe për to kishte hetime të nisura, duket se nuk qëndron. Kjo për faktin se, përkundër këtij argumenti: (i) duke qenë një çështje që i përkiste një shtet të agruar kryesisht me procedime nën akuzën e “vjedhjes” dhe “fshehjes së të ardhurave”, akuza të cilat kërkojnë vëmendje në trajtimin e tyre, regjistrimi i procedimit, mbledhja, administrimi i provave dhe kryerja e hetimeve të nevojshme, duhet të ishin konsideruar si domosdoshmëri në favor të zbardhjes së çështjes. Ky vlerësim i trupit gjykues vjen si rezultat edhe i pasojave të pariparueshme që mund t’i shkaktohen buxhetit të shtetit në rast të provueshmërisë së akuzave. Në këto argumente, minimalisht do të duhej që çështja të ishte regjistruar dhe më tej të ishte vlerësuar bashkimi i saj me procedimet e tjera, duke shtuar në këtë mënyrë morinë e provave në favor të hetimit. Ndër detyrat e lëna nga gjykata në prishjen e vendimit vërehet se detyra parësore ka qenë regjistrimi i procedimit dhe më tej janë renditur edhe detyrat e tjera. Nuk duket e arsyeshme ngarkesa në punë e pretenduar nga subjekti, në raport me akuzën e ngritur nga kallëzuesi. Nga ana tjetër, detyrat e lëna nga gjykata i përkasin disa veprimeve të rëndësishme hetimore për t’u kryer, të cilat kanë kërkuar padyshim kohën e nevojshme për t’u përmbushur. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se kthimi i çështjes për hetime të mëtejshme i atribuon subjektit mungesën e efektivitetit në përmbylljen e fashikullit hetimor në kohë dhe për pasojë duket se ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96⁸⁴/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, por edhe të kriterëve të përcaktuara në rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër kriteret dhe kërkesat e përcaktuara si bazë për

⁸⁴ Nenet 73/2,3 dhe 74/4 citojnë se: “[...] Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe [...] matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme [...]”.

vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit është edhe efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimi i një procedimi penal.

8. Denoncimet⁸⁵ e shtetasit K.Zh.

8.1 Sikurse citohet më sipër në denoncimin nr. *** për çështjen Zh., ka depozituar denoncim edhe shtetasi K. Zh., i cili ankohet ndaj subjektit, duke vënë në diskutim edhe etikën në sallën e gjyqit. Denoncuesi ka depozituar edhe ankimin e avokatit mbrojtës, i cili, ndër të tjera, ka parashtruar se nga ana e organit të akuzës është bërë hetim jo i plotë, me tendencën për të deklaruar fajtor të mbrojturit prej tij që në fillimet e para të çështjes objekt hetimi.

8.2 Në lidhje me këtë denoncim, subjektit i është kërkuar⁸⁶ të japë shpjegime të detajuara për secilin rast.

8.3 Subjekti, në shpjegimet e tij, ka sqaruar:

- *“Pretendimi i mosrespektimit të etikës në gjykim nga ana ime është i pavërtetë. Debati i zhvilluar në gjykim ka qenë korrekt, kërkesat e paraqitura nga ana ime kanë qenë të mbështetura, intonacioni korrekt, si dhe është respektuar solemniteti gjyqësor.*
- *Lidhur me hetimin e kryer në funksion të çështjes penale nr. *** të vitit 2017, theksoj se hetimi i këtij procedimi penal ka qenë i lidhur me procedimin penal nr***të vitit 2013, ku janë proceduar shtetasit E.L. dhe E. A., për veprën penale të “mashtrimit”, parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal⁸⁷.*

*Shtetasi H. K., në lidhje me ngjarjen për të cilën qenë proceduar shtetasit E.A. dhe E. L., u paraqit dhe dha një kallëzim të ri penal në lidhje me shtetasit J. Zh. dhe A. Zh., djemtë e shtetasit K.Zh. . Lidhur me këtë kallëzim penal kam biseduar me drejtuesin e prokurorisë, duke i bërë me dije se ndaj personave kishte të dhëna për të cilat nevojitej hetim, por diskutimi nga ana teorike ishte nëse ndodheshim para parimit ‘gjë e gjykuar’. Duke vlerësuar se një nga kushtet për t’u ndodhur para ekzistencës së këtij parimi mungonte, u vendos të nisej procedimi penal në datën 10.5.2017 dhe si unë, edhe drejtuesi ishin të këtij mendimi. Kemi regjistruar procedimin penal dhe janë kryer veprimet hetimore të deleguara. Në përfundim, janë ngritur akuzat dhe çështja është dërguar për gjykim. Në të gjithë veprimtarinë time, kam mbajtur një qëndrim profesional. Ankuesi pretendon se është bërë një hetim jo i plotë, por nuk deklaroi se cilat veprime hetimore nuk janë bërë (sipas këndvështrimit tim, janë kryer të gjitha veprimet hetimore). Në bisedën që shtetasi K.Zh. ka regjistruar në zyrën time, të transmetuar në emisionin ‘Fiks fare’ në Top Channel, unë kam përmendur faktin që djemtë e tij, sipas bindjes sime, ishin fajtorë, fakt që u konfirmua nga vendimi nr. ***, datë 2.11.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, që i deklaroi ata fajtorë dhe nga vendimi nr. ***, datë 28.5.2021, i Gjykatës së Apelit Gjirokastër. Gjithashtu i kam thënë z. K. që nuk kishte pse më*

⁸⁵ Denoncimet nr. *** prot., datë 20.11.2018, dhe nr. *** prot., datë 11.6.2020.

⁸⁶ Me pyetësin nr. 3, datë 1.7.2021.

⁸⁷ Para ndryshimeve të vitit 2017 në Kod, ku u ndryshua marzhi i dënimit dhe u shtua edhe një paragraf.

pyeste mua për bisedat që ai bënte me viktimën H.K., pasi unë e kisha mbaruar trajtimin e rastit”.

8.4 Subjekti ka depozituar: kopje të fashikullit të procedimit penal nr. *** të vitit 2017; vendimin nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; si dhe vendimin nr. ***, datë 28.5.2021, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

8.5 Nga analiza e dokumentacionit të administruar, vërehet se pretendimet e avokatit mbrojtës (datë 8.11.2018, drejtuar në formë ankimi para gjykatës së apelit), të paraqitura nga denoncuesi bashkëlidhur denoncimit, kanë qenë pjesë e shqyrtimit dhe debatit gjyqësor në gjykatën e apelit, në përfundim të të cilit kjo e fundit është shprehur në vendimin nr. ***, datë 28.5.2021. Në pretendime avokati i referohet vendimit nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, nëpërmjet të cilit shtetasi J. Zh. është deklaruar fajtor për veprën penale të “mashtrimit”, parashikuar nga nenet 143/3 dhe 25 të Kodit Penal dhe është dënuar me 6 vjet burgim, ndërsa shtetasi A. Zh., për të njëjtën veprë penale, është dënuar me 5 vjet burgim. Gjykata e Apelit Gjirokastrë, me vendimin nr. ***, datë 28.5.2021, ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet e avokatit mbrojtës dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 2.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Denoncuesi F. D. referon çështjen e bërë mediatike lidhur me kamerën e fshehtë, ku denoncuesi K. Zh.(babai i dy vëllezërve të dënuar) takon babain e kallëzuesit (H. K.) dhe më pas subjektin e rivlerësimit. Në emisionin investigativ⁸⁸ duket se mbahen komunikime midis shtetasve K.Zh. dhe H. K., ku përmendet edhe emri i subjektit, më pas edhe me këtë të fundit.

8.6 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me videon e pasqyruar në emisionin investigativ, duke qartësuar pozitën e tij në lidhje me këtë çështje.

8.7 Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar: *“Lidhur me videon e publikuar në këtë emision, u qëndroj shpjegimeve që kam dhënë më parë. E kam pritur shtetasin K. Zh. në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, pasi ai kërkoi takim. Nuk e dija që po e regjistronte bisedën. Në bisedë i kam thënë se unë kam përfunduar me çështjen dhe nuk kishte pse më kërkonte mua se çfarë do të bënte me viktimën H. K. . Lidhur me sugjerimin për shlyerjen e dëmit civil që i kam bërë këtij personi në kohën kur çështja ka qenë në hetime, unë e kam sqaruar edhe në këtë takim K., se në bazë të ligjit prokurori mund ti sugjerojë të pandehurit ndërmarrjen e hapave që lehtësojnë pozitën e tij, siç parashikon neni 48 i Kodit Penal, por kjo nuk do të thotë që mosndërmarrja e këtij hapi çon në rëndim dënimi. Dhe është fakt që gjatë hetimeve janë zëvendësuar masat e sigurimit dhe në gjykim, dënimi ka qenë afër minimumit të tij.*

Komunikimi im ka qenë etik e zyrtar dhe regjistrimi i bisedës nga ky person, megjithëse akt jo i drejtë dhe i kritikueshëm moralisht, i ka shërbyer më së miri vënies në pah të seriozitetit dhe integritetin tim në ushtrimin e detyrës”.

⁸⁸ <https://top-channel.tv/video/fiks-fare-denoncuesi-une-e-rregulloj-me-prokurorin-me-jep-50-milione-leke/>
<https://top-channel.tv/video/fiks-fare-krveprokurori-i-gjirokastrës-zgjidhe-vete-me-denoncuesin/>

8.8 Trupi gjykues, në analizë të thelluar të çështjes, sikurse është parashtruar më sipër, vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të detajuara lidhur me të gjithë situatën e themelit, pra me hetimet e kryera dhe dënimet e kërkuara dhe merituar ndaj të akuzuarve, dhe njëkohësisht ka sqaruar në mënyrë bindëse edhe mbi komunikimin e prezantuar në videon e pasqyruar në emisionin investigativ, përtej çdo sjelljeje joetike, komprometuese apo denigruese që ka lidhje me ushtrimin e detyrës së tij. Në thelb të çështjes duket se ka qëndruar impenjimi i denoncuesit për të implikuar me zë dhe figurë subjektin, për shkak të dënimit të kërkuar prej këtij të fundit ndaj dy djemve të denoncuesit, pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe akuzave të ngritura për ta, situatë e cila duket se ka rezultuar në disfavor të qëllimit të këtij të denoncuesit. Në të tilla kushte, duket se nuk u diktuan fakte apo rrethana të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues, duke pasur në konsideratë:

- pikën 1, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”*;
- nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”*;
- vendimin nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet: *“[...] në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL - AD (2016)036 të Komisionit të Venecias);*
- nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë – arsyeton se:

Mangësitë e konstatuara në çështjen e bërë prezent nga denoncuesit M. Sh. (procedim i vënë në lëvizje nga e dëmtuara, nëna e saj L. Sh.) dhe F. D. (procedim i vënë në lëvizje nga kallëzimi i shtetasit Gj. B.), pasqyruar në rubrikën e trajtimit të denoncimeve të depozituara në Komision, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, i cili ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e tij.

Sa më sipër, si dhe për shkak të kufizimit për të mos zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit, trupi gjykues vlerëson se vetëm mangësitë e gjetura për sa më sipërsarsytuar mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor të tij, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, për t’u vlerësuar më tej nga organi kompetent.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues i Komisionit

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se për subjektin e rivlerësimit Juljan Çafka nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se dërgimi për inspektim i çështjeve të hetuara nga subjekti është i pamjaftueshëm për të arritur në vlerësimin e tij, sipas germave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues, sipas neneve 44/a dhe 59/c të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Çafka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Transferimin e çështjeve penale që i përkasin përkatësisht, procedimit penal nr. ***, datë 16.7.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pezulluar me vendimin e kësaj prokurorie në datën 7.8.2020, dhe procedimit penal nr. ***, datë 1.10.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për të cilin është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore”, bazuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.9.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

ETLEDA ÇIFTJA
Kryesuese

Roland ILIA
Anëtar

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta